

# KOQVARIJA

Ballina: Violette Gashi



**KOSOVA SI SHTETI  
I NASTRADINIT**

**S'E KAM GAJLEN  
E VOTIMIT,  
POR T'BUKËS**

**MUSA HOTI  
VRAU AMBASADORIN  
E PLAGOSI DY TË TJERË**

**KOHA E SODIT  
NUK I DO PLEQTË**

**Violette Gashi**  
diva shqiptare e extensions  
sjell brendin e saj  
edhe në Kosovë







SHERWOOD  
Resorts and Hotels



GREENWOOD  
Resorts and Hotels

*feel the legend*



ANTALYA | TÜRKİYE



SHERWOOD  
Gölköy Resort



SHERWOOD  
Gölköy Lara



SHERWOOD  
Dünya Resort



SHERWOOD  
Pamukaltı



3UE  
Türkiye  
Seyahat



GREENWOOD  
Kızıllı Resort



GREENWOOD  
Kızıllı Beach

[sherwoodhotels.com.tr](http://sherwoodhotels.com.tr) | [greenwoodhotels.com.tr](http://greenwoodhotels.com.tr)

+90 444 86 07

# Kosova si shteti i Nastradinit!

*Populli e do shtetin, por politikanët e shfrytëzojnë shtetin për qëllimet e veta...*

Nastradini e kishte një lopë, nga e cila edhe e mbante familjen me qumësht. Por, lopa sëmuret dhe ngordh. Ai filloi të qajë, por askush nuk e pajtonte.

Për fat të keq, gruaja i kishte vdekur një muaj para se t'i ngordhte lopa, e s'kishte kush as ta ngushëllonte...

Kur i kishte vdekur gruaja, Nastradinin askush nuk e kishte parë duke qarë.

Por, kur fqinjët e panë duke qarë për lopën e ngordhur, nga kureshtja e pyetën:

"Pse qanë për lopën Nastradin, kurse për gruan që të vdiq para një muaji nuk të pa kush duke qarë?!"

Nastradini u përgjigjet:

"Kur më vdiq gruaja fqinjët më thanë se kanë me ma gjetur një grua edhe më të mirë dhe nuk kisha arsye të qaja.

E, tash, që më ngordhi lopa, nuk vjen

askush t'më thotë se kanë me ma ble një lopë tjetër!"

E, kështu janë edhe politikanët tanë: Qajnë për mallin e tyre nëse e humbin, e jo edhe për shtetin!

## GARË SE KUSH E VARFËRON POPULLIN MË SHUMË!

Çdo kund në botën e civilizuar garojnë për të marrë poste për t'i shërbyer shtetit e popullit, e te ne garojnë për ta kapë shtetin dhe për ta varfëruar popullin!

Ishin dehur dy vetë.

Pas mesnate ktheheshin në shtëpi.

Hëna ndriçonte mirë.

Njëri, e që digjej së brendshmi nga rakia, i thotë tjetrit:

"Kam vapë nga ky diell që ngrohë shumë!"

Tjetri i thotë:

"Nuk është dielli, por hëna!"

Dhe, njëri dielli e tjetri hëna, nisin të grinden...

Ndërkohë, aty pari kalon një burrë.

"Jaran, do të na tregosh a është hëna a dielli ky që ngrohë tash?", i thotë njëri prej tyre.

Ai ngriti kokën drejt qiellit, vuri dorën mbi vetulla dhe tha: "Nuk po e njoh! Nuk jam i këtij vendi!"

Ja, kështu është edhe te ne: Njeriu askujt s'i bie në fije!

## BOTA PO LUAN ME NE...

Edhe 25 vjet pas lufte me ne po befasonen të gjithë! Neve po na qesin kushte e kritere më të ashpra se të tjerëve!

Çudi, a?

**Burim Bajrami**

# Mendojmë se jetohet vetëm nga politika!

*Me fillimin e fushatës elektorale për zgjedhjet e 9 shkurtit 2025, në televizionet tona më s'ke çka pret, s'ke çka sheh! Debat pas debati, analist pas analisti, lajm pas lajmi...*

*Thënë shkurt, kjo është përditshmëria jonë!*

## KISHA DASHTË TË DASHUROJA...

Në vend të lajmeve pa kufi, të debateve politike maratonike, kisha dashtë t'më thoshte dikush yll ndriçues. T'më thoshte - bota ime! T'më thoshte - drita ime... Kisha dashtë që të flitej më shumë për jetën, për dashurinë, që ta shijonim bukurinë e fundit oqeanik. E, në oqean kisha dashtë të ishte AJO anije imja, në të cilën valët do t'më kishin dremitur për një gjumë të rehatshëm, pa ankthe. Kisha dashtë ta shqelmoja stresin, të mos merrem me të, në mënyrë që kur të zgjohem në mëngjes, nëse do isha zgjuar, të mos zgjohem duke dënesur!



## NGA DASHURIA A BUDALLAKIA?

Dhe, ngado që sillem, më së miri më bie të flas për dashuri... Një mbrëmjeje dhjetori më pyeti një shoqe imja, e që ishte në zor prej burrit: "Çka t'i them burrit, bre, se jam në hall prej tij, nuk po më lëshon assesi? Më përcjell si hijja! As te shoqet nuk më lë të shkoj! Nuk e di a e ka nga dashuria a nga budallakia?!". Pasi u mendova gjatë, i thashë: "Thuaj: Kështu është jeta, si libri i heshtjes, me 111 faqe bardh, në të cilat autori nuk shkroi asgjë, meqë ka pasur shumë të thotë, sa nuk ka filluar të shkruaj fare! Andaj, edhe jeta është e tillë: Atë që e do nuk të do!". Dhe, arsyeya pse po merrem tash me

dashuri është që të relaksohem pak, meqë na mbyti politika! Jemi politizuar shumë, ndoshta më shumë se cilido popull në botë!

## SIDOQOFTË, MENDOJMË SE JETOHET VETËM NGA POLITIKA!

E këtu edhe qëndron gabimi... Andaj, kisha dashtë që ta lëmë anash politikën dhe t'i buzëqeshim jetës. Të buzëqeshim të gjithë, madje edhe bashkëshortët që grindën ndërmjet veti, edhe ata që janë dashur e ende duhen, edhe ata që janë mbushur xheloz, edhe ata që ëndrrat i shndërrojnë në dëshira...

**Burim Bajrami**





# Dashurohem shpejt e ndahem edhe më shpejt!

Jam vajzë 30-vjeçare. Jam e lindur në Malishevë, por jetoj në Gjermani. Momentalisht jam në pushim në vendlindje.

E dua një djalë me të cilin shihemi më shumë në vendin e punës, por unë nuk jam e vendosur për askënd, sepse më duket kam depresion: Dashurohem shpejt dhe ndahem shpejt! Pra, nuk mund t'i shkoj deri në fund asnjë lidhjeje!

Kështu, si duket, kam probleme me veten, nuk jam e sigurt në rrugën që marrë...

Çka po ndodh me mua?

**Leudita, Malishevë**

*Ke qenë në lidhje disa vjet me një burrë të martuar dhe jeni ndarë.*

*Synimi yt ka qenë që ta marrësh për burrë, por s'keni pasur sukses.*

*Andaj, shpirti të ka mbetur te ai.*

*Dhe, sado që dashurohesh shpejt, edhe largohesh shpejt!*

*E, për të krijuar një lidhje më stabile lypset kohë. Mirëpo, tash për tash, ti nuk je e gatshme për një gjë tillë, sepse truri dhe shpirti duhet të mësohen me një pamje të re, me një sjellje të re që vjen nga personi që do ta gjesh.*

*Sepse, njeriu nuk është makinë statike që funksionon vetëm kur ndizet, por në çdo kohë është në funksion me kapacitetet e veta psiko-motorike, që do të thotë të shërohen ndjesitë që keni krijuar për aq kohë*

*sa ke qenë në lidhje me personin që nuk e ke më...*

*Megjithatë, fjala e urtë popullore thotë "Koha shëron!"*

*Dhe, pa dyshim, besojmë se edhe më ty do të ndodhë një gjë e tillë...*

Radio,  
Lajme, Moti,  
Video, TV, ...

Vetëm me aplikacionin  
**Shkabaj** për Android

ANDROID APP ON  
Google play

KOSOVARIA | 5

# S'e kam gajlen e votimit, por t'bukës!



*“Kur po më shohin njerëzit se në çfarë gjendje jam, ka të atillë që duan t'më japin edhe ndonjë cent për lëmoshë. Por, unë nuk dua lëmoshë, dua punë...”, thotë T. Jahiri, 50 vjeç, i cili çdo ditë del në treg të Prishtinës për të shitur pemë.*

I veshur me rroba jo edhe aq të trasha, ani pse sivjet dimri është shumë i ftohtë, T. Jahiri, 50 vjeç, çdo ditë del në tregun e Prishtinës për të shitur pemë, të cilat herë-herë edhe i prishën nga i ftohti i këtyre ditëve.

Në një qosh të trotuarit zë vend dhe pret kush do të blejë ndo gjë prej tij. As vetë s'di se sa herë gjatë ditës përsërit refrenin e njëjtë: “Urdhëroni molla t'mira e t'lira!”.

Me buzët e thara e pa shtirë gjë në gojë tërë ditën, T. Jahiri, baba i 3 fëmijëve, 2 prej të cilëve ende janë në shkollim, i lodhur së tepërmi dhe i plogësht me shëndet, të jep të kup-tosh sikur i është dorëzuar mjerimit, armikut të madh e të pamposhtur. Me një buzëqeshje të brishtë mundohet të tregojë se si është duke frymuar vetë i katërti në familje, në një dhomë të ftohtë të shtëpisë matën hekurudhës, pas xhamisë së Llapit në Prishtinë.

## **Çka shet më së shumti?**

- Molla dhe qepë.

## **Ku i merr?**

- I blej prej një myshteriu nga Koliqi.

## **Sa para të mbesin nga një kilogram molla?**

- 20 centë.

## **Sa fiton brenda një dite?**

- Nganjëherë hiq më shumë se 5 euro.

## **Ku jeton?**

- Mbrapa hekurudhës.

## **A ke shtëpi tënden?**

- Po, e kam një shtëpi të vogël. Të ftohtit hyn kah të dojë...

## **Sa fëmijë i ke?**

- I kam 3 fëmijë. 2 prej tyre janë ende në shkollim. I madhi është martuar dhe është ndarë nga ne, sepse nuk kisha dhomë për të. Jeton me qira te një fqinj yni. 100 euro paguan qira vetëm për një dhomë që ka.

## **A punon ai?**

- Punon kur ka punë. Çdo mëngjes del herët në pazar për t'u shitur si argat krahu. Verës është pak më mirë, sepse edhe punë gjendet aty-këtu, kurse dimrit e ka më keq, meqë pak kush punon...

## **A merr ndihmë nga komuna?**

- Çfarë ndihme, more?! Po kush t'i lëshon sytë sot! Më thonë: I ri je ti, pse nuk punon?!

E, i mirë për politikanët tanë je vetëm nëse del e voton për ta.

I mirë je edhe nëse del në tubime për vota elektorale dhe bërtet çka të thonë ata...

Dhe, pas votimit ma kush nuk të pyet a je gjallë a jo, a ke bukë a jo, a ke dru a jo...

Por, sivjet kam vendosur të mos dal në votim. Do i këqyri punët e mia e politikanët le të bëjnë çka të donë vetë...

## **Nuk pret gjë prej politikanëve, a?**

- Jo, sepse secili që po vjen në pushtet këqyrë si me u pasurua vetë.

E, çifti jem prapë jemi këtu, në trotuar, në vapë e në të ftohtë, duke u munduar të sigurojmë bukën për anëtarët e familjes.

## **E paç një ditë me fitim!**

- Të lumtë goja! Kurrë këtë fjalë s'ma ka thënë kush deri tash...

I. ILAZI

# DEPUTETI KËRKON VOTËN NË FSHAT, FËMIJA IA JEP MAT!



Pa dyshim, u ka rënë të dëgjoni edhe ju se nëpërmjet katër gjërave që i kanë njihen çfarë janë:

Pema nga frutat e saj.

Gruaja në mungesë të burrit.

Bujaria në varfëri.

Shoku në vështirësi.

Ndërsa, tri gjëra nuk mund të rrinë të fshehura: hëna, dielli dhe e vërteta.

Sot shumë aktuale për popullin tonë, e vlen thënia: Bëhuni si pemët. Ndryshoni gjethet po jo rrënjët. Ndryshoni idetë, por ruani parimet, zakonet, traditat shqiptare, me të cilat kemi qenë të veçantë në botë.

Në kohën e tashme aq shumë është prishur morali sa të jesh i moralshëm të quajnë të prapambetur.

Luftova ta gjeja të drejtën te të tjerët dhe

vdiqa duke e marrë me vete.

Shumë fytyra të pafytyra po bëhen në jetën tonë.

Pse?

Sepse, shkon një ministër në një fshat dhe pas fjalimit e premtimeve të mëdha, i afrohet një fëmije.

Dhe, duke e përkëdhelur, e pyet:

“Çfarë të sjell kur të vij herën tjetër?”.

“Një palë këpucë”, i përgjigjet fëmija.

“Çfarë numri?”, e pyet ministri, pa ia hequr dorën nga faqet.

“43!”, i thotë fëmija.

“43?! Po ti ende je i vogël për atë numër!”, i thotë deputeti.

“Kur të m’i sjellësh këpucët unë do jem i rritur!”, ia kthen fëmija.

**Gani Dili**

## KOSOVARJA

magazinë e pavarur  
për familje

[www.kosovarja.al](http://www.kosovarja.al)

**Pronar dhe botues:**

Gani DILI

**Redaktor përgjegjës:**

Isa ILAZI

**Menaxher:**

Driton DILI

**Redaksia:**

Safet Krivaça (reporter i lirë)

Nderim Neziri (redaktor)

Besiana Dili

Drenushë Haredinaj

Ardita Dili

Edona Vllasaliu - Bajoku

Xheneta Spahiu

Denisa Oruqi

**Dizajni:**

Labinot Bërbatovci

**Adresa e redaksisë:**

Fahu postal 18, 10000 Prishtinë

Tel: 038 51 75 75

Email: [info@kosovarja-ks.com](mailto:info@kosovarja-ks.com)

**Marketing:**

Tel: +383 44 143 448;

Email: [marketing@kosovarja-ks.com](mailto:marketing@kosovarja-ks.com)



Jetë, o jetë...

# Nuk po më merr kush për grua!

*Jam nga Klina. Ditë më parë i mbusha 30 vjet. Në shkollë të mesme nuk isha e rehatshme. Njëjtë vazhdova edhe në fakultet. Por, edhe kur u punësova vazhdova me avazin e vjetër...*

Kur u ngopa aventura, vura gishtin në kokë dhe thashë me vete:  
Ku më qon kjo rrugë?  
A jetohet gjithmonë prej një maskulli te tjetri?  
Kur do të krijoj edhe unë familje?

Dhe, çka jo tjetër...  
Por, në këto pyetje është dashur të mendoja më herët, atëherë kur isha nxënëse e shkollës së mesme, sepse në vend që të mësoja - shëtisja me biznesmenë anekënd Kosovës, anekënd Shqipërisë...

## AS NË FAKULTET NUK U MBUSHA MEND!

Por, e keqja më e madhe ishte se njëjtë vazhdova edhe në fakultet, përkundër faktit se kisha edhe obligim që ta kryeja fakultetin.

Thënë shkurt, paradite shkoja në ligjërata, pasdite mësoja në bibliotekë, ndërkaq në mbrëmje vend të preferuar kisha kafenetë dhe diskotekat.

E, më e keqja ishte se edhe pasi diplomova dhe gjeta punë në një firmë private, as

këtu nuk isha e rehatshme, ani pse orari i punës ishte goxha i gjatë.  
Por, me kalimin e kohës vëreja se shoqet e mia të fakulteti që moti ishin martuar, kishin krijuar familje, kishin lindur fëmijë...

## E UNË...

Unë rropatesha nga pasojat e një jete të shfrenuar rinore, që dikur shoqet ma kishin lakmi, e tash i lakmoj unë ato...  
Kështu, kam ardhur në gjendje që t'ia marr inati vetes pse isha aq budallaqe, pse s'e vrisja mendjen për pasojat që më prisnin...  
Konkretisht, në të tridhjetat, po i vuaj pasojat e një jete rinore të shfrenuar, e cila po më hakmerret tash, meqë askush nuk po më merr për grua.  
Dashtë Zoti e asnjë vajzë të mos e ketë fatin tim!

Luna, Klinë



## Violette Gashi

# diva shqiptare e extensions sjell brendin e saj edhe në Kosovë



“Studio Divaa” është vulë suksesi e shqiptares Violette Gashi, e lindur e rritur në Francë, ku edhe vazhdon të jetojë e ve-projë.

Violetta ka një eksperi-encë të gjatë profesionale si një nga femrat më të zonjat në zanatin e saj si frizere. Njihet si mjeshtre e balayage dhe si specialiste për extensions. Violette Gashi ka krijuar edhe markën e saj për extensions, të quajtur “Divaa extensions”, që veçohet për kualitet e cilësi të jashtëzakonshme.

Flokët extensions të “Divaaa Extensions”, tashmë kanë ardhur edhe në Kosovë, në Ferizaj. Lokali furnizon sallonet e tjera të bukurisë me flokët e “Divaa extensions”.

Pra, dyqani është i specializuar për shitjen e flokëve me tipsa të tejdukshëm dhe me extensions nano keratine.

Në ballinën e revistës sonë, “Kosovarja”, imazh është Violette Gashi, grua e suksesshme dhe e pandalshme në profesionin e saj.



### **Kush është Violeta, një prezantim juaji?**

- Jam Volette Gashi, me origjinë nga Ferizaj, por jetoj dhe veproj në Francë. Që nga mosha 17-vjeçare punoj si frizere.

Këtë profesion e dua dhe e ushroj me pasion të veçantë.

### **Si nisi rrugëtimi juaj në këtë profesion?**

- Ishte dëshirë e kahershme, e fëmijërisë. Nisa shumë e re dhe jam e lumtur për zgjedhjen që kam bërë.

### **Cilat janë aftësimet tuaja profesionale?**

- Jam specialiste për extensions (shtesa) të flokëve me teknikën recocking.

### **Na fol për sallonin tënd të bukurisë?**

- Prej vitit 2014 kam firmën time të quajtur "Studio Divaa", që gjendet në Annemasse, e ku nuk më ka munguar suksesi.

E kam blerë lokalin dhe kam shtuar shërbime të tjera, si: botox të flokëve, laser për trup, bërjen e thonjve dhe një mori shërbimesh të tjera profesionale.

### **Njiheni si specialiste e flokëve?**

- Jam specialiste për extensions të flokëve edhe balayage blond edhe traitement cacao.

### **Pse vendosët ta quani "Studio Divaa"?**

- Sepse të gjitha femrat janë diva dhe në studion tonë trajtohen tamam si të tilla...

### **Flokët e "Diva extensions" tashmë njihen kudo. Si lindi ideja për ta pasur brendin tuaj?**

- Me vite e kisha këtë ide, që, më në fund, u bë realitet dhe tashmë produkti ynë është në treg dhe njihet për kualitetin e pakrahasueshëm që ka.

### **Çfarë i bënë ndryshe dhe të veçantë shtesat e flokëve të brendit tuaj?**

- Cilësia edhe origjinaliteti janë të pakrahasueshme dhe mund të përdoren deri në gjashtë herë, kurse pjesa e ngjitjes është e tejkushme.



Pra, pamja finale është krejtësisht natyrale dhe e jashtëzakonshme.

**Tashmë “Studio Divaa” është edhe në Ferizaj. Na flisni pak më në detaje?**

- Tashmë salloni është hapur dhe ka nisur të ketë sukseset e para. Kemi sjell edhe në Kosovë flokët e brendit tonë dhe, kështu, të gjitha femrat mund të përfitojnë nga kjo mundësi e mrekulueshme.

**Në Ferizaj do të bëhet vetëm shitja, apo edhe vënia e flokëve të “Divaa extensions”?**

- Do të bëhet shitja për sallonet që duan të furnizohen me flokët e markës tonë, e që ja vlejné për arsyet që tashmë i theksuam në këtë bisedë.

Po ashtu, bëhet edhe vendosja e flokëve për klientët tona.

**Cila është formula juaj e suksesit?**

- Është ndihma e Zotit dhe puna ime e pandalshme për t'i bërë realitet qëllimet e mia në jetë. Andaj, jam falënderuese për këtë që kam arritur...

**Kujt i thua faleminderit për të gjitha arritjet?**

- Vetëm Zotit!

**Çfarë të bënë ndryshe nga gratë e tjera?**

- Nuk jam ndryshe, vetëm se nuk kam frikë të rrezikoj.

**Pasionet tua në jetë?**

- Puna që bëj, profesioni im, flokët.

**Diçka për jetën private?**

- Jam e martuar që 16 vjet, e realizuar edhe në jetën private. Jam nënë e lumtur e dy fëmijëve: një djali dhe një vajze.

**Për fund?**

- Kisha dashur që vajza ime, Lorina, në të ardhmen t'i gëzoj bizneset e mia e të bëhet femër e aftë, e suksesshme dhe e guximshme.

**Nderim Neziri**





# Pse ikim nga Kosova?

*Një muaj kohë që njerëzit e Kosovës e kanë në dorë shansin ta ndryshojnë pak a shumë jetën e vet me të mira më shumë se që i kishin...*

Kur i dëgjon premtimet e partive politike, njeriu nuk di kujt t'ia jep votën, sepse premtimet janë "kalavesh rrushi"!

Të gjithë flasin për patriotizëm e për të mirat që do t'i japin popullit...

Ajo që më së shumti është e dhimbshme është fakti se politika e këtij vendi është shumë e ndarë.

Në fund të fundit, krejt po garojnë për një shtet më ligjor.

## CILA ISHTE GJENDJA DERI TASH?

Është folur e përfolur se parlamentarë më të papërgjegjshëm se ky i legjislacionit të fundit nuk ka pasur kurrë Kosova, sepse delegatët më shumë nuk kanë marrë pjesë në mbledhjet e Parlamentit sesa që kanë qenë pjesë e tij. Fjalët më të shpeshta nga kryeparlamentari kanë qenë "nuk ka kuorum"! E, ç'është më e keqja, pozita, në të shumtën e rasteve, e bojkotonte Parlamentin, e që rrallëkund në botë ndodhë një gjë e tillë!

Thënë shkurt, ishte një kuvend që as për interesa shtetërore e kombëtare nuk fliste me një gjuhë, e jo tregon më së miri se çfarë strukture parlamentare ka pasur Republika e Kosovës.

Deputetët, madje, edhe për tema të rëndësishme të interesit nacional, në vend se të merren me interesin

shtetëror, hapnin plagë të vjetra kush çka ka bërë...

## E, KU ËSHTË POPULLI?

Po kush po mendon për popull, ore?! Faktet tregojnë se populli është lënë nën mëshirën e fatit!

Populli i Kosovës, megjithatë, i ka rrugët e hapura për ta lëshuar vendin, sepse vende pune nuk ka, perspektiva nuk shihet as në fund të tunelit për shumicën e popullatës, e të tjera të ngjashme...

Ndërkaq, për ata që janë në pushtet kurrë më mirë nuk ka qenë: i kanë punësuar familjarët dhe të afërmit e tjerë, e për popull kush brengoset, ore?!

Por, çudia është edhe më e madhe kur politikanët tanë thirren në popull, në qytetarët e vendit!

Shtrohet pyetja: Kush i pyet qytetarët, popullin?!

**S. Krivaça**





Musa Hoti në zyrën e tij

# Me dy plumba vrau ambasadorin e plagosi dy të tjerë

*Musa Hoti është modeli më i mirë i atdhetarit, shembull se si jetohet, punohet, kontribuohet dhe sakrifikohet për lirinë dhe pavarësinë e popullit dhe të vendit të vet. Ai vret një dhe plagos tre punëtorë të sigurimit jugosllavë në Bruksel. "As sot e kësaj dite nuk e kam të qartë se si ia dola që me dy plumba ta vras një dhe t'i plagos tre serbët që më sulmuan".*

## Shkruan: Akademik Frashër Demaj

Musa Hoti u lind më 11 korrik 1946, në Mitrovicë. Rridhte nga një familje tradicionale shqiptare. I edukuar me njerëzi e urti, duke parë e dëgjuar ngjarje e tregime për të atin e gjyshin dhe bashkëmendimtarët e bashkëluftëtarët e tyre ndër vite, Musa po krijonte një përfytyrim të qartë për pozitën e popullit të tij të vuajtur në Jugosllavi dhe për përpjekjet e pareshtura të breznive ndër vite për liri e bashkim kombëtar. Në shkollën fillore Musa dallohej si nxënës i shkëlqyer në mësimet, me prirje për prozën e poezinë dhe artet në përgjithësi. Dhe, përderisa ai ende nuk e kishte kaluar fazën e fëmijërisë, filloi ta njohë e përjetojë dhunën e shtetit të Jugosllavisë. "Drejtësia" jugosllave i kishte në shënjestër familjet që gjatë historisë kishin treguar vendosmëri e atdhetarizëm. Në këtë kuadër Prokuroria kishte ngritur aktakuzë kundër babait të tij, Dautit, shkaku se ai kishte qenë bashkëluftëtar i Shaban Polluzhës. Dauti edhe pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore bënte pjesë në grupet patriotike të kohës, të cilat ishin të dëshpëruara me pozitën e Kosovës dhe popullit shqiptar. E, në këtë valë dhune kundër shqiptarëve, organet e ndjekjes arrestuan dhe e burgosën Dautin, me aktakuzën për "veprimtari armiqësorë", prishje të frymës së bashkim-vëllazërimit dhe cenim të rendit kushtetues të RSFJ-së. Në akuzën e ngritur ndaj Daut Hotit, thuhej:

"Për veprimtari armiqësorë kundër popullit dhe shtetit".  
Burgosja e babait, bastisjet e shtëpisë, dhuna fizike e psikologjike, Musa Hotit i lanë gjurmë të thella dhe të pashlyera. Dhe krejt, natyrshëm, të gjitha këto së bashku, nxiten urrejtjen për Serbinë e Jugosllavinë dhe forcuan edhe më tej idealin për çlirim të Kosovës dhe bashkimin me Shqipërinë.  
Musa sa më shumë që rritej, aq më qartë e kuptonte se dhuna ndaj babait dhe familjes së tij, si dhe ndaj shumë familjeve të tjera shqiptare, ishte me motive politike dhe përpjekje e vazhdueshme për ta ndëshkuar dhe ngulfatur atdhedashurinë e shqiptarëve për Kosovën dhe për kombin.  
Si nxënës i shkollës së mesme në Mitrovicë, Musa përjetoj sërish atë ndjenjën e keqe të përndjekjeve politike. Tani cak i policisë ishin bërë disa profesorë të shkollës, si: Veton Gjika, Mustafa Muni dhe Mustafa Venhari, të cilët shërbimi sekret jugosllav i likuido, kurse disa të tjerë, si: Murat Bejtën, Latif Berishën, Ahmet Malokun e Muhamed Kërveshin, i mbante gjithë natën në burg, duke i torturuar, kurse ditën i lironte thua se s'kishte ndodhur gjë.

## PJESËMARRËS I DEMONSTRATAVE TË VITIT 1968

Në vitin shkollor 1966/67 Musa filloi punën mësues në shkollën tetëvjeçare "Rilindja" në Dobroshevc të Drenasit, ngase në Mitrovicë dhe rrethinë nuk mund të punësohej shkaku

i biografisë familjare dhe i "karakteristikave irredentiste". Pakënaqësia dhe kërkesat e shqiptarëve për t'i gëzuar të drejtat si të gjithë popujt e Jugosllavisë dhe për t'u respektuar të drejtat e tyre kombëtare, i nxitën shqiptarët në konkretizimin e kërkesave politike.

Kërkesat politike të shqiptarëve u shfaqën hapur në demonstratat e vitit 1968 në shumë vise të Kosovës. Musa Hoti ishte pjesëmarrës aktiv i këtyre demonstratave. Në një intervistë të dhënë para se të vritej ai, përshkruante gjithë përpjekjet e plejadës së tij për liri e bashkim kombëtar. Aty përshkruante edhe pjesëmarrjen e tij në demonstratat e 68-së dhe, në mes tjerash, theksonte: "...Më 27 nëntor 1968, me trenin e pasdites, u kthyem në Fushë-Kosovë e prej aty vazhduam për në Prishtinë me Haxhi Gashin, Enver e Haki Berishën, Musli Elshanin, Emine Rakovicën, mësuese në Bardh të Madh, me vëllanë e së cilës, me Hilmi Rakovicën (dëshmor), isha në lidhje organizative. Kur turma e pafund zbriti nga Fakulteti Filozofik, iu bashkëngjijtën demonstruesve në mënyrë spontane. Pas vrasjes së Murat Mehmetit, demonstruesve iu bashkëngjijtën turma nxënësish të shkollave të mesme, punëtorët dhe qytetarët e Prishtinës. Ky manifestim mori përmasa gjithë popullore. Demonstruesit, që i prinin manifestimit të dalë nga kontrolli, thyen të gjitha vitrinat e dyqaneve në të dy anët e rrugës (tani "Nëna Terezë") dhe ndonjë veturë zyrtare aty-këtu. Në tri javët e ardhshme, me propozimin e Hilmi Rakovicës, u mora me organizimin e demonstratave që nga Tetova deri në Manastir".

Musa Hoti punonte në Drenas. Ishte banor i Mitrovicës, por banonte në Prishtinë. Prandaj, në një farë mënyre, u "kishte humbur gjurmë" organeve të ndjekjes dhe pushtetit.

Por, kjo situatë nuk zgjati shumë, meqë atëbotë institucionet politike dhe pushteti i Gillogovcit (Drenasit) e shpallën person të papërshtatshëm politikisht.

Musa, pasi u largua nga Gillogovci, filloi punën në Obiliq, por pas një viti punë, me urdhër të Komitetit, e larguan nga shkolla "Migjeni".

Më pas u punësua në Mitrovicë, në Qendrën Teknike "Boris Kidriç", por as aty nuk gjeti rehati. Punëtorët e Sigurimit Shtetëror e maltretonin dhe torturonin dhe si pasojë e maltretimeve psikike e fizike Musa u detyrua të largohet dhe të marrë rrugën e mërgimit.

## MUSA HOTI LARGOHET NGA KOSOVA

Meqenëse Musa ishte vënë në shënjestër dhe ndiqej nga organet e sistemit të sigurimit jugosllav, atij nuk i mbetën shumë alternativa. Dy ishin zgjidhjet që mund të bënte: ose të vuante burgun e rëndë për botëkuptimet e tij politike dhe aktivitetet kombëtare ose të largohej përkohësisht nga Kosova. Dhe, u largua nga Kosova për t'u vendosur në Belgjikë.

Edhe atje vazhdoi veprimtarinë politike e patriotike në shërbim të Kosovës dhe kombit shqiptar. Në mërgim Musa Hoti gjeti një diasporë të përçarë ideologjikisht, me probleme të shumta, me akuza e kundër akuza ndaj njëri-tjetrit, me dyshime për "spionë" e UDB-ashë të përhapur në klube e shoqata shqiptare.

Të shumtën e rasteve dyshimet ishin të pa bazua, por, në anën tjetër, duhet sjellë në vëmendje se shteti jugosllav kishte infiltruar shumë punëtorë të sigurimit shtetëror për të përcjellë aktivitetet e shqiptarëve në Evropë. Pra, ishte një situatë shumë e paqartë dhe delikate, ku vështirë ishte të dihej e të dallohej kush është me mision kombëtar e kush ishte spion i UDB-ës, meqë të gjithë trumptonin idenë e patriotizmit, secili më patriotë se tjetri në deklarata e në dalje publike.

Sepse, ata që kishin për mision spionimin, duhej të shtireshin si patriotë të devotshëm, përndryshe nuk mund të hynin thellë në organizata e grupe revolucionare për t'i zbuluar e denoncuar, madje edhe për t'i vrarë, siç ndodhi me shumë atdhetarë: Jusuf e Bardhosh Gërvallën, Kadri Zekën, Enver Hadrin etj.

Musa Hoti, sikurse shumica e të ardhurave nga Kosova në kurbet, kishte ideologji majtiste. Kishte individë që prireshin me ide të ekstremit të majtë, grupe marksiste-leniniste. Këto grupe dalloheshin edhe për nga emërtimi, si, për shembull, Fronti i Kuq, Lëvizja Marksist Leniniste etj.

Musa Hoti kishte arritur në Bruksel më 9 nëntor të vitit 1978. Aty kërkonte strehim të përkohshëm, të paktën, derisa të pushonin

ndjekjet e pushtetit ndaj tij.

Dhe, si të gjithë të tjerëve që kërkonin strehim politik në Belgjikë, ashtu edhe Musait, Komisarati për Refugjatët Politikë ia lëshoi fillimisht një letër të thjeshtë, me të cilën mund të shëtiste kudo në territorin e shtetit belg, por me këtë dokument nuk kishte të drejtë të dalë jashtë Belgjikës.

E, me kalimin e kohës, i kishte rregulluar të gjitha dokumentet që i mundësuan të kishte leje të përhershme qëndrimi në shtetin belg. Dhe, meqë Musa u rehatua në Belgjikë, mori atje edhe familjen e vet të ngushtë.

## AKTIVITETI I MUSA HOTIT NË BRUKSEL

Aktivitetin politik e atdhetar Musa Hoti e vazhdoi edhe në Bruksel, madje me intensitet të shtuar. Ai ishte anëtar i KQ të Lëvizjes, forum ky shumë i rëndësishëm që merrte vendime të ndryshme në favor të çështjes për të cilën ishin bashkuar.

Musa Hoti ishte ndër njerëzit kryesorë përgjegjës dhe aktiv për formimin e grupeve politike në Belgjikë, madje ai kishte arritur të krijonte grupe e lidhje edhe në vende të tjera të Evropës, si dhe në SHBA.

Pas ngjarjeve të pranverës së vitit 1981, një numër i madh i emigrantëve shqiptarë u angazhuan që ta ringjallin emigracionin në Belgjikë. Me këtë pretendohet që të bëhej një organizim më i mirë politik për t'i dhënë shtytje, jo vetëm kërkesave qytetare e kombëtare të studentëve në Prishtinë, por edhe të sensibilizohet opinioni perëndimor për pozitën tejet të rëndë të shqiptarëve në Kosovë dhe Jugosllavi.

Kjo situatë vuri në veprim UDB-ën që të jetë edhe më aktive në ndjekjen e aktivistëve shqiptarë në Evropë. UDB-a planifikonte të vriste e likuidonte aktivistët shqiptarë, t'i frikësonte dhe t'u pamundësonte të tjerëve t'i bashkëngjiteshin aktivitetit politik në shërbim të Kosovës dhe interesave të popullit shqiptar në Jugosllavi.

Në këtë shënjestër siguri jugosllav kishte piketuar edhe Musa Hotin. Përpjekjet për të likuiduar Musën dhe detajet e ngjarjes ku ai vrau një dhe plagosi 3 të tjerë, i shpjegon vetë në një intervistë ekskluzive dhënë revistës "Zëri", më 1 qershor 1996. Në këtë intervistë Musa Hoti, mes të tjerash, theksoi: "Rasti ndodhi asaj nate, kur një bashkatdhetar yni nga Peja, që kishte ardhur atyre ditëve në Bruksel dhe e kishte të shoqen shtatzënë, më thirri pas punës. Unë pranova të shkoja dhe ta ndihmoja për t'u vendosur në banesën që e kishte siguruar atyre ditëve. Mirëpo, derisa po shkoja te miku im, përnjëherë jam shtangur kur kam vënë re se shtatë persona, të gjithë korpulentë, më ishin vënë pas. Ata, sapo m'u afruan, nisën t'më kërcënojnë në gjuhën serbe.

Thënë të drejtën, në fillim nuk e kuptova qëllimin e tyre definitiv, nuk e dija se çfarë po mëtonin asaj nate dhe se a ishin, me të vërtetë, njerëz të UDB-ës. Mirëpo, mendova

se mund t'më kishte identifikuar ndonjëri prej atyre se isha shqiptar dhe tashti ashtu kot po më provokonin, ngase ishin aq në numër dhe kishin marrë zemër, ashtu siç e kanë adet të gjithë serbët".

Musa mbante revole me vete, por, sidoqoftë, nuk ishte fort i interesuar të përballej me ta. Në këtë situatë ai hyn në Restorantin "White Horse". Pasi hyn në restorant, ulet pranë disa shqiptarëve që i takon rastësisht aty.

E, pas tij ishin futur edhe agjentët e UDB-ës, të cilët kishin filluar ta shajnë e ta fyejnë Musa Hotin dhe, siç shpjegon më tej ai: "...kur udbashët e panë se mbeta i vetmuar, nisën t'i nxjerrin armët që t'më vrasin. Ata ishin katër rreth tavolinës, ndërsa tre kishin ngelur jashtë. Unë isha i ulur pranë dritares, kështu që plumbat mund t'më godisnin nga dy drejtime – nga jashtë dhe nga brenda në të njëjtën kohë... Ata i futën duart të parët që t'i nxjerrin armët dhe t'më vrasin. Mirëpo, unë, nuk e di as vetë se me ç'shtytje, ia dola që me shpejtësi të rrufeshme ta nxjerr revolen dhe shtiva i pari në mbrojtje legjitime. Njëri prej sulmuesve u vra në vend, ndërsa tre të tjerët i plagosa. Thënë të drejtën, as sot e kësaj dite nuk e kam fort të qartë se si ia dola që në mënyrë ekzakte me dy plumba ta vras një dhe t'i plagos tre persona të tjerë".

Tre serbët e tjerë, e që gjendeshin jashtë, nuk kanë ndërmarrë asnjë veprim të vetëm, ngase e tëra ndodhi me shpejtësi të pashpjegueshme. Dhe, kur Musa kishte dal nga restoranti, siç thotë "për të mbaruar punë" edhe me ta, nuk i kishte pa, sepse ishin larguar. Pas këtij akti Musa ishte larguar nga vendi i ngjarjes me hapë të ngadalshëm, ndërsa më pas, në një rrugicë tjetër, kishte marrë taksin dhe ishte larguar me idenë për t'u dorëzuar në polici. Por, në ndërkohë, siç shprehet vetë ai, kishte ndërruar mendje me arsyetimin se ata të parët e kishin sulmuar, kurse ky ishte vetëmbrojtur.

Pasi ishte arratisur Musa Hoti, e kishte dërguar një mik në Ambasadën e Shqipërisë në Paris për të kërkuar ndihmë me qëllim që t'i sigurohej një lloj strehimi i përkohshëm atje. Përderisa ai priste përgjigjen, të cilën duhej ta merrte nga Ambasada e Shqipërisë në Paris, policia belge i kishte rënë në gjurmë. Musa Hoti paraburgoset.

Hetimet lidhur me rastin kanë vazhduar afërsisht tetëmbëdhjetë muaj dhe më pas policia belge ndaj tij aplikon një lloj izolimi në bregdetin e atij vendi. Këtë veprim policia e arsyetonte me rrezikun dhe mundësinë e vrasjes së Musa Hotit nga agjentët e UDB-ës jugosllave.

## PËRPJEKJET E UDB-ës PËR TË VRARË MUSA HOTIN

Pasi Musa u kthye nga "izolimi", UDB-a jugosllave bëri edhe disa përpjekje për ta likuiduar fizikisht. Rasti i parë kishte ndodhur kur Musa po zbriste me gruan dhe fëmijët





Musa Hoti me vajzën Mimosën në Mitrovicë më 1978

me ashensor nga kati i katërt i ndërtesës ku jetonte. Duke pritur ashensorin ata dëgjojnë një eksplozim të madh e të pazakontë, por nuk e kishin idenë se çka po ndodhte përjashta, ndoshta edhe nuk u shkonte mendja se i gjithë ai detonim ishte kurdisur kundër tyre.

Pasi zbritën poshtë e kuptuan se vetura e tyre ishte hedhur në ajër.

Përpjekja e dytë për të vrarë Musa Hotin kishte ndodhur në periudhën kohore kur ai jetonte në periferi të Brukselit, në fshatin Sent Piters Lër. Gjithashtu, duhet thënë se me rekomandimin e policisë belge, e cila druante se Musa do të mund të vritej nga UDB-a, ky i fundit detyrohej që shumë shpesh ta ndërronte vendbanimin.

Përpjekja e radhës e UDB-ës, për ta cenuar dhe eventualisht për ta zënë në "përpjekje për akte terroriste" dhe për ta ekstraduar Musën në Jugosllavi, kishte ndodhur në vitin 1987, kur policia federative e Jugosllavisë kishte bërë një kërkesë zyrtare dhe kërkonte nga INTERPOL-i që të bastiseshin një numër familjesh shqiptare, me pretekst se ishin terroristë që po përgatishnin veprime kundër Jugosllavisë dhe përfaqësive të saj ekonomike e diplomatike në Evropë.

Pas kësaj kërkesë, më 27 nëntor të vitit 1987, policia bastisi 44 familje shqiptare në disa shtete evropiane. Ndër to ishte edhe ajo e Musa Hotit. Mirëpo, në asnjë rast, policia nuk gjeti armë e as eksploziv, siç kishte pretenduar policia jugosllave.

## LIRIMI I MUSA HOTIT NGA BURG

Jugosllavia kishte angazhuar ekspertët e vet të drejtësisë ndërkombëtare dhe tërë potencialin diplomatik që rigjykimi të bëhej në bazë të gjyqimit që ishte bërë në Belgjikë. Dhe, duke parë se në Këshillin e Evropës nuk mund të ndikonte ashtu siç e kishte planifikuar, diplomacia jugosllave vë kusht që, edhe nëse lirohet Musa, nuk duhej të jetonte në Bruksel.

Procedura në burgun hetues zgjati 22 muaj. Gjyqi i Strasburgut vendosi që Musa të lirohej brenda një afati të shkurtër njëmuajor

dhe në ndërkohë të jetonte në Belgjikë për një afat të shkurtër derisa të gjente një shtet, i cili do të pranonte ta strehonte.

Belgjika, bazuar në aktgjykim, detyrohet që më 8 nëntor 1984 ta lirojë Musën nga burgu. Lirimi i Musës nga burgu ishte me të njëjtin kusht: gjetje strehimi në një shtet tjetër. Përveç këtij kushti Musa ishte i detyruar që çdo javë të paraqitej në policinë e lagjes dhe të mos e lëshonte pragun e banesës së tij pa dijeninë e policisë.

## KONTRIBUTI I MUSA HOTIT NË FORMIMIN E LIDHJES SË ARSIMTARËVE SHQIPTARË NË BELGJIKË

Përveç aktiviteteve politike në diasporë, një nga segmentet më të rëndësishme ishte organizimi dhe vajtja e nxënësve me mësim plotësues në gjuhën shqipe. Me ardhjen e Neriman Brahës dhe Rexhep Osmanit në Belgjikë, u krijuan kushte të favorshme që Musa të jepte kontributin e vet edhe në fushën e arsimit.

Pas konsultave e takimeve të vazhdueshme me bashkatdhetarë dhe njohës të çështjeve të arsimit në Belgjikë, u formua një këshill nismëtar për themelimin e Lidhjes së Arsimtarëve Shqiptarë (LASH). Nismëtarët e këtij aktiviteti, sa human aq edhe kombëtar, ishin: Sami Rexhepi, Kujtim Hajdaj dhe Musa Hoti. Musa, duke qenë edhe me një të kaluar prej mësimdhënësi, tregonte interesim dhe afinitet të jashtëzakonshëm që fëmijët e shqiptarëve në Belgjikë dhe në gjithë diasporën të mos e harrojnë gjuhën shqipe. Musa Hoti kishte dhënë kontribut të madh edhe në mbledhjen e ndihmave për arsimin shqip në Belgjikë e Kosovë, si dhe kontribute të tjera në interes të vazhdimit të lëvizjes për çlirim e bashkim kombëtar.

## MUSA HOTI VRITET NË QENDËR TË BRUKSELIT!

Pas çlirimit Musa Hoti do të vinte në Kosovë me vullnetin më të madh për të jetuar në

vendlindjen e tij, bashkë me fëmijët dhe gjithë familjen. Gjatë vizitës së tij në Kosovë, përveç prindërve dhe vëllezërve, Musa Hoti tërë kohën e kalonte me miq e shokë, duke diskutuar për aktivitetet kombëtare, e duke u çmallur me shokë e atdhetarë, të cilët nuk i kishte takuar me vite të tëra.

Arsyeja pse Musa Hoti insistonte të mos qëndronte në Bruksel, por të kthehej në vendlindje, ishte fakti se gjithë jetën kishte ëndërruar e kishte punuar për çlirimin e Kosovës.

Në nëntorin të vitit 2003 Musa kishte rregulluar gati çdo gjë dhe kishte marrë vendim të prerë - të jetonte në Kosovë. Në dhjetor të vitit 2003 Musa duhej të kthehej në Bruksel, për të rregulluar dokumentin e tij të fundit të shpërnguljes për në Kosovë. Ai po nisej me zemër të thyer, sepse po e linte vëllanë, Idrizin, shumë të sëmurë dhe pa shpresa të mëdha për jetë.

Në Bruksel, pasi kishte rregulluar një dokument në administratën vendore, ishte kthyer në një klub të shqiptarëve. Pastaj, një mik i tij, Sabit Abazi, duke mos dëshiruar që Musa të ecë këmbë, merr veturën e tij që ta dërgojë deri në shtëpi. Musa, kur afrohet te metroja, kërkon nga Sabiti ta ndalojë veturën e të nisej me metro në shtëpi...

Në mëngjesin e 17 janarit 2004 trupi i Musa Hotit gjendet i vdekur në parkingun e metrosë "Art Lois".

Bulevardi "Art Lois" është ndër bulevardet më të frekuentuara të Brukselit. Në njëfarë mënyre aty është rrugëkryqi i Parlamentit Evropian, Ambasada Amerikane etj. Pra, thënë shkurt, është zonë shumë e frekuentuar dhe e përcjellë me kamera për shkak të masave të sigurisë.

Musa Hoti u vra me një plumb pas koke. Specialistët e kriminalistikës dhe ata të mjekësisë ligjore të Belgjikës, në raportin e tyre, kishin nxitur dyshime se trupi i vrarë i Musës ishte zhvendos nga vendi ku ishte vra dhe dërgohet në një parking metroje. Sidoqoftë, vrasja e Musa Hotit u krye në mënyrë shumë profesionale dhe pa lënë gjurmë e argumente për dyshim e zbulim të akterëve që bënë këtë vepër kriminale. E, për çudi, as kamerat e metrosë nuk posedojnë xhirime të kalimtarëve të rastit e as të qëllimshëm, gjë që forcon edhe më shumë idenë se Musa Hoti u vra nga vrasës profesionistë.

Sidoqoftë, vrasja e atdhetarit që gjithë jetën ia kushtoi lirisë dhe atdheut, natyrisht, ishte humbje e madhe për të gjithë Kosovën dhe shqiptarët.

Varrimi i atdhetarit Musa Hoti u bë ditën e mërkurë, më 21 janar 2004, në varrezat e dëshmorëve në Prishtinë. Për nder të jetës dhe veprës së tij u organizua një ceremoni mortore nën përkujdesjen e institucioneve shtetërore të Kosovës për ta nderuar e përcjellë në mënyrë meritore e madhështore, ashtu siç është zakoni të përcillen figurat e rëndësishme kombëtare.



Pamje e fshatit Binçë

# Pse temë shkrimi e kam fshatin Binçë të Vitisë?

*Lidhjet e Kroacisë me Kosovën historikisht janë shumë të qëndrueshme dhe të vjetra. Shqiptarët dhe kroatët ndajnë më shumë se miqësi që rrodhi nga lufta në Kroaci më 1992, ku qindra shqiptarë luftuan për Kroacinë...*

Ish-presidenti kroat, Stipe Mesiq, është nip i arbëreshit Josip Relja. Dalmatët, banorët autoktonë të bregdetit Adriatik, janë me prejardhje ilire. E, ata që jetojnë sot në ato treva e pranojnë me mburrje se rrjedhin nga gjaku ilir.

Atje përgjatë bregdetit mbretëron mbiemri Ballaban, Gashiq e Berishiq, sikur në Janjevën e braktisur. Pra, lidhjet e Kroacisë me shqiptarët e Kosovës nuk janë sforcuar vetëm në luftën e vitit 1992 në Kroaci, por kanë funksionuar edhe kur Serbia i helmoi nxënësit shqiptarë në shkollat tona më 1990. Qysh atëherë Kroacia ofroi barëra për nxënësit e helmuar shq-

iptarë, të cilat i distribuoi në kishën e Binçës së Vitisë.

Memorien për kishën e Binçës ma ktheu një deklaratë e një kroati, që kishte kaluar një kohë jete në burgjet e Serbisë me shumë shqiptarë, duke thënë se shqiptarët i ka vëllezër dhe se në burgjet e Jugosllavisë ata kurrë nuk e kishin tradhtuar për asgjë.

## ÇKA PARAQET BINÇA E VITISË?

Binça, momentalisht fshat me shumë borë, i vendosur rrëzë kodrave, sivjet

dimri shijohet më mirë se kurrë më parë, shkak i reliefit malor, e ku rreth rrugës janë ndërtuar shumë restorante tradicionale.

Dhe, teksa kaloj përgjatë Binçës, shoh shtëpitë e miqve të dikurshëm që flisnim për Binçën si fshat i lashtë. Aty ndodhet kisha, e cila para 35 vjetësh me motrat e nderit pranonin nxënësit e helmuar nga Serbia në vitin 1990, e ku shëroheshin me barërat që vinin nga Kroacia.

Andaj, teksa po e trupoj Binçën, sjell disa kujtime të dikurshme në rikthimin e memories së para dhjetëra vjetëve...



## BINÇA - FSHAT ME HISTORI ILIRE

Kisha e Binçës ka një historik për mburrje. Ajo vazhdimisht ka qenë në shërbim fetar dhe humanitar për skamnorët, por edhe për nevojtarët tjerë.

Kishën e Binçës dikur e pat vizituar edhe ish-presidenti i Shqipërisë, Bujar Nishani, i cili shprehte kureshtjen dhe interesimin për një pjesë historie kombëtare që ndodhi këtu.

Pjesë e dhimbjes është edhe ndihma e kishës dhënë nxënësve të helmuar në vitet e nëntëdhjeta, kur krijoheshin kolona automjetesh me nxënës që u helmuan nga Serbia.

Të dielat në Binçë kalojnë, zakonisht, në dinamikën e lutjeve ceremoniale në kishë.

Ndonëse ditë pushimi, banorët, por edhe të tjerët nga rrethina e Vitisë e Ferizajt, pushtojnë fshatin që ka një qendër te ura, aty ku degëzohen tri rrugë për në pjesë të ndryshme të Binçës.

Sidoqoftë, ky fshat, që nuk është më larg se pesë kilometra nga Vitia, mban rekordin për vjetërsi në këtë komunë, por edhe reputacionin e mirësisë dhe humanitetit, me çka Binça mburret për shqiptarizëm dhe traditë.

Mbaj mend bisedën me Nikollë Gegajn, rreth të gjashtëdhjetave, banor i fshatit Binçë, që mban marketin më të madh në fshat, duke treguar historikun se si Binça është fshati më i rëndësishëm në Kosovë.

Ai tregonte se si dukej dikur Binça dhe si është sot, në Kosovën e lirë...

"Binça është fshati më i vjetër jo vetëm në Viti, por edhe në rrethinë. Thuhet se vetëm Kamenica është e vjetër sa Binça.

Vjetërsinë e fshatit e dëshmojnë edhe pikturat në kishë, dymbëdhjetë sosh, që tregojnë për historikun e fshatit.

Për lashtësinë e fshatit kemi dëgjuar qysh në oda, kur pleqtë tregonin histori të ndryshme dhe interesante për traditë dhe luftërat, e që vend të rëndësishëm zë lufta turke për myslimanizmin me dhunë të banorëve dhe rezistenca e tyre për ta ruajtur të kaluarën e vet.

Njëra ndër pikturat që ndodhet në



Kisha e Binçës

kishën e Binçës tregon, pikërisht, një pamje se ata që nuk do ta praninin ndërrimin e fesë do të vriteshin mizorisht në rrugë...

Fshati Binçë rrjedh nga emërtimi i lashtë ilir, që do të thotë "fshat i fuqisë".

Në fshat sot ka ndryshime demografike. Dallimin e bën, kryesisht, ndryshimi demografik serb, e që këtu dikur ka qenë i madh e tash është ndryshe...

Sepse, edhe ata pak serbë që kanë mbetur në fshat, janë pleq.

Në Binçë më parë nuk ka pasur popullatë shqiptare myslimane, mirëpo tash janë dhjetëra sish, të ardhur kryesisht nga fshatrat Debëllde dhe Tanishec", thoshte para një kohe Nikollë Gegaj.

Sidoqoftë, Binça tash ka rreth 220 shtëpi dhe paraqet fshatin modern të komunës së Vitisë, me një shumicë të rinjsh në mërgatën evropiane.

Në fshat jetojnë në harmoni të mirë të gjithë dhe askush nuk e ruan shpinën prej askujt, edhe pse Binça në fund të luftës së vitit 1999, konkretisht më 13 qershor të atij viti, ka pasur djegie të disa shtëpive nga serbët.

### Ç'THOSHTE MOTRA E NDERIT PËR NXËNËSIT E HELMUAR SHQIPTARË?

Dhe, teksa eci përgjatë Binçës me borë, më kujtohet Jelena Anxheliq, motër nderi në kishën e Binçës, e cila më pat thënë se në po këtë kishë kishte shërbyer 40 vjet.

Ulur afër ambulancës së kishës, i kujtonte ngjarjet e kaluara në kishë dhe ata që janë ndihmuar gjatë viteve...

E, duke vënë theksin në ngjarjet dhjetë vjet para lufte dhe deri në

mbarim të saj në vitin 1999, tregonte se çka kanë përjetuar shqiptarët...

"Kemi bërë atë që kemi mundur në kishë. Duam të jemi modestë, por janë shënuar dhe evidencuar të gjitha. Kemi dhënë rregullisht atë që kemi poseduar - barëra dhe bukë.

Më e tmerrshme që kemi përjetuar ka qenë koha e helmimit të nxënësve shqiptarë në vitet nëntëdhjetë. Kolona e njerëzve që kërkonin ndihmë ishte e gjatë.

Në atë kohë furnizoheshim me barëra nga qendrat më të mëdha mjekësore në Kroaci: Zagrebi, Spliti, Dubrovniku, Zara dhe vende të tjera, e që i siguronte "Karitasi".

Sidoqoftë, ishte kohë e rëndë. Kemi përjetuar një dramë që nuk e kishim menduar, sepse kur shihnim qindra nxënës të helmuar brenda ditës, me të vërtetë, ishte rrëqethëse.

Megjithatë, ndihmë mjekësore japim edhe tani. Por, ajo kohë paraqet diçka që bënim çdo ditë...

E, edhe në luftë kemi pasur mbi 200 refugjatë që i kemi mbajtur gjatë kohës së luftës. Kanë qenë, kryesisht, njerëz të moshuar, por ka pasur edhe të sëmurë, e që stafi ynë u ka dalë në ndihmë.

Andaj, kisha dhe fshati ynë gjithmonë janë mburrur dhe mburren për humanitet që kemi dhënë dhe ndihemi krenarë që kurrë nuk ka pasur e as nuk ka dallime fetare a etnike", thotë Jelica, motër nderi.

Në fund, teksa e rrumbullakësoj këtë vizitë në Binçë të Vitisë, Nikolla tregon se truallin për kishë e ka falur babagjyshi i tij, Gegë Sopi.

"Ne me fis jemi Sop. Jemi shumë të afërm me shqiptarët e Kaçanikut", thotë në fund të bashkëbisedimit tonë Nikolla.

Safet Krivaça





KOMPLEKSI ELIZA PARK A


SUHAREKĚ

your perfect **HAVEN**

+383 44 106 777  
[www.cimaks.com](http://www.cimaks.com)





A black and white photograph of a man, Lidi, smiling and wearing sunglasses and a white suit. He is making hand gestures with both hands. A tattoo with the word "temporary" is visible on his chest. A necklace with a cross pendant is also visible. The background is black.

**BOOM**

**Lidi, animator  
më i famshëm shqiptar,  
përtej maskës...**





**Lidi,  
animatori  
më i famshëm  
shqiptar,  
përtej  
maskës...**

*Lidi Delia është i veçantë, i jashtëzakonshëm, artist shumë dimensional. Është animatori më i famshëm shqiptar, i cili organizon evenimente e festivale të mahnitshme.*

*Personazh "përtej të zakonshmes" në skenë e jetë, Lidi në këtë intervistë në "Boom" flet më tepër për veten.*

*Ish-banori i "Big Brother VIP Albania" tregon më shumë këtë herë...*

**Lid, si e përshkruan veten me pak fjalë?**

- Shpirt energjik, plot pasion dhe gjithmonë i hapur për t'u lidhur me të tjerët.

**Si të përshkruajnë të tjerët?**

- Më thonë që jam karizmatik, por edhe pak karagjoz.

**Je animatori më i njohur shqiptar. Si filloi kjo?**

- Që në fëmijëri kam pasur fatin të kem afër shtëpisë një qendër sociale dhe nga kjo ka nisur gjithçka. U rrita me dashuri të madhe dhe me dëshirën për t'i bërë të tjerët të lumtur.

**Cilat janë planet tua në aspektin profesional?**

- Së bashku me ekipin tim, gjatë muajit mars do të sjellim një kanal magjik, në të gjitha platformat online, me muzikë të bukur dhe edukative për fëmijët.

**Kush është ekipi yt dhe a janë nga Kosova a Shqipëria?**

- Të gjithë flasim shqip, por jemi gjysmë nga Kosova dhe gjysma nga Shqipëria. Paola, Dj Benito dhe Matë Films janë shqiptarë nga Shqipëria, ndërsa Flaka, Vanesa dhe Ridvani janë shqiptarë nga Kosova.

**Cilat janë ambiciet e këtij projekti?**

- Ne duam të bëjmë një revolucion në fushën e materialeve artistike për fëmijë, duke krijuar përmbajtje që do të jetë e dëgjuar në çdo skaj të botës. Synojmë të ofrojmë produkte muzikore dhe edukative që ndikojnë pozitivisht në zhvillimin e fëmijëve dhe të bëhemi një burim i panjohur deri më tani për kreativitetin dhe mësimin në shkallë globale.

**Materialet do të jenë në shqip apo në anglisht?**

- Çdo produkt muzikor do të jetë në shqip dhe në anglisht, për të pasur mundësi më të lehta për të arritur tregun ndërkombëtar.

**Si do ta quani projektin dhe çfarë mund të na tregoni tjetër për të?**

- Gjithçka do ta publikojmë shumë shpejt, prandaj le të mbetët surprizë për momentin.

**Mes Shqipërisë dhe Kosovës, zgjedh...?**

- I dua të dyja! Shqipëria më rriti, ndërsa Kosova më formoi. Momentalisht, ndjehem shumë mirë në Kosovë







### **Po bëhet një vit nga hyrja jote në "BBVA". Si e kujton atë eksperiencë?**

- Fillimisht, i jam shumë mirënjohës "Top Channel" për mundësinë që ma dha. Ishte një aventurë e vështirë, por me shumë emocione dhe mësim të çmuara.

### **A do ta përsërisje si eksperiencë?**

- Po, do doja shumë të merrja një ftesë nga "Big Brother VIP Kosova". Hyrja ime në "BBVA" ishte shumë vonë dhe publiku më identifikoi si "Vëllanë e Heidit", e kjo bëri që të ishte më e vështirë të dal në sipërfaqe.

Nuk arrita të tregoj historinë time dhe Lidi i vërtetë nuk u njoh. Publiku më pa, thjesht, si "Vëllai i Heidit" dhe kjo ndikoi shumë. Prandaj, do të doja një mundësi tjetër për të qenë pjesë e atij formati nga dita e parë dhe jo për të provuar si eksperiencë, por për të luftuar dhe për të fituar atë.

### **Kush mendon se e meriton fitoren në këtë edicion?**

- Në "Big Brother VIP Kosova" do të doja të fitonte Vullneti, ndërsa në Shqipëri jam ndërmjet Gjestit dhe Valbonës.

### **Jeta jote përtej skenës dhe biznesit?**

- Po qëndroj pranë bashkëshortes sime, Paolës. Në fillim të muajit shkurt do të bëhemi prindër për herë të tretë. Pas Pios dhe Galës, me pa durim presim që familjes sonë t'i bashkohet djali ynë i tretë, Jofieli.

### **Për fund?**

- Jeta është një udhëtim me shumë emocione, por momentet e vërteta arrihen vetëm kur jemi vigilentë, duke i hapur sytë për mundësitë që fshihen mes çdo dite dhe çdo ndodhie.

Emocioni nuk është gjithmonë i dukshëm, por ai është aty për ata që e shohin.

Kam mësuar se koha kalon shpejt, prandaj nuk duhet ta lëmë të na shpëtojë pa e jetuar plotësisht. Çdo moment është një mundësi për të krijuar kujtime, për të dashuruar, për të mësuar dhe për të qenë të pranishëm.

Dhe, po nuk e shijove tani, koha nuk do të kthehet më!

**Nderim Neziri**





# Koha e sodit *nuk i do pleqhtë!*

*Një vaki e pazakontë më ndodhi në natën e Vitit të Ri. E, çka, mësoni në vijim...*

Në natën e Vitit të Ri, si nënë e vakive që jam, teksa dua ta blej në treg një gjel, e që nuk gjendet asnjë as për ilaç, nisem për në Gadime.

Posa dal në rrugën kryesore, te "banesat e arabëve" në periferi të Prishtinës, një vajzë ngrit dorën që ta marrë me veturë.

Kur e ndala veturën u fut brenda pa më pyetur se ku po shkoj.

"Si je? Si e ke nënën, babën? Si janë në shtëpi?", më thotë.

E shikoj mirë në sy, mos po del e familjes, por më bie në mend se nëna dhe baba më kanë vdekur që moti.

"Mirë jemi. Nëna e baba më kanë vdekur, kurse të tjerët mirë jemi".

"Bash mirë që të paskan vdekur, për

besë, sepse koha e tashme nuk duron më pleq!", më tha.

"Më fal, a i ke njohur ti prindërit e mi, a?!", ia kthej.

"Jo-jo, nuk i kam njohur, por ma merr mendja se kanë qenë të vjetër".

"E ti, sa vjeçe je?", i them.

"Po, ku pyetet femra për moshë, o burrë!", shpejt ma pret ajo.

"Mirë e ke, por ti nuk po më dukesh se ke hyrë në rend të femrave, sepse qenke e re!".

"A po më dërgon deri në Lipjan se e kam një shoqe të bukur atje?", ma ktheu në vend të përgjigjes.

"A po zbret këtu se unë nuk shkoj në Lipjan!", i them, teksa edhe e ndali veturën në mes të rrugës.

"A po ma blen, pra, një pako cigare, pashë Zotin, se sot nuk e kam pi asnjë cigare?", thotë pa fije turpi.

Zoti është i madh, them me vete.

Dhe, përnjëherë më silltet në mendje se, ndoshta, edhe vajza ime është diku rrugëve, duke i ndalur veturat si kjo, apo duke u lypur cigare.

Dhe, mirë që e zbrita se kushedi çka do të ndodhte me të...

Por, në çast m'u kujtua Polonia, koha kur ne, shqiptarët e Kosovës, shkonim atje, shumica për vajza të reja...

E tash, në Kosovë, vijnë polakët dhe, me siguri, kënaqen me femrat tona, sepse nuk thonë kot se asgjë nuk mbetet për dynjanë tjetër...

S.



## Inserte lufte +18 vjeç

*Këto inserte janë shkëputur nga ngjarje të pasluftës që janë bërë në fshatrat ku kanë ndodhur krimet serbe. Janë inserte që nuk u dedikohen lexuese nën 18 vjeç, shkaku i përmbajtjes së tyre...*

Nata kishte qenë shumë e frikshme. Paramilitarët serbë sapo kishin tmerruar popullatën në Izbicë të Drenicës. Kishin vrarë e masakruar shumë shqiptarë dhe i kishin varrosur. Për të fshehur krimin i kishin rihapur varrezat dhe i kishin nxjerrë kufomat. I kishin djegur për së gjalli disa civilë në fund të livadhit. E kishin bërë me qëllim që ta trishtonin popullatën... Mëngjesi i hershëm i fund-prillit e kishte gjetur fshatin nën granatimet e ashpra serbe. Të strehuarit kishin dal nga shtëpitë, ku e kishin bërë natën, të frikësuar. Një nënë kishte dy vajza-binjake. Rrugës, gjatë ikjes, i mbante në duar të dyja. Kishte arritur të ikte nja një kilometër nga fshati. E lodhur dhe e molisur, nëna e binjakeve kishte vendosur ta linte njërin në arë. E kishte lëshuar njërin në arë dhe vazhdon me tjetrën në krah të ikte. Një grua, që dukej se ishte e fundit në atë turmë, e kishte dëgjuar fëmijën teksa qante e bërtiste në arë dhe e merr me vete. Nëna e fëmijës së lënë në arë kishte shkuar nga një qerre në tjetrën dhe kishte përfunduar në Shqipëri, e prej atje në Francë. Ishte mërzhitur për binjaken e lënë në fushë, aq sa nuk kishte bërë më gjumë asnjë nate të vetme. Por, gruaja që e kishte gjetur fëmijën e lënë, e që nuk dinte se e kujt ishte, kishte mbetur në një fshat jo larg. Tri net kishte fjetur në kaçuba dhe natën e katërt ishte kthyer në fshat. Kishte fare pak banorë të cilët flinin në shtëpitë e fshatit, pasi shumica kishin ikur. Forcat serbe pas bastisjes së fshatit kishin ecur tutje, duke e bartur çdo gjë logjistike prej aty. Fëmija ishte lodhur urie. Gruaja, e që ishte bërë nënë në pleqëri, duke menduar se si ta rriste, kishte hasur në një lopë, e cila nga pamja e gjinje jepte të kuptosh se ka qumësht po ta milje. E mjelë lopën dhe me qumështin e saj fillon ta ushqej fëmijën.



# Si e la nëna binjaken në arë?

## PAS DY VJETËSH...

Lufta kishte dy vjet që kishte përfunduar dhe nëna e binjakes, e që ndodhej në Francë, kishte vendosur të kthehej në vendin ku e kishte lënë para dy vjetësh binjaken tjetër. Me binjaken që e kishte me vete, kishte shkuar në fshatin ku e kishte bërë natën e fundit gjatë kohës së luftës. Aty ku kishte ndodhur nata e saj më e keqe dhe dita e saj më tragjike, aty ku e kishte lënë vajzën binjake, aty ku ishin ndarë binjaket. Aty ku e kishte lënë një pjesë shpirtit, aty ku ishte thyer zemra e nënës dhe ku loti i saj ishte kristalizuar për të mos harruar asgjë

që kishte ndodhur. Ishte endur poshtë e lartë fshatit, duke pyetur nëse dinte kush gjë për një fëmijë të "humbur", që e kishte lënë para dy vitesh. Askush nuk dinte gjë, meqë banorët e atyshëm ishin shpërndarë pikë e pesë, si zogjtë e qyqes, siç thuhet në popull. Nëna e binjakes kishte vizituar varrezën e fshatit që të shihte nëse kishte ndonjë varr të ri në përmasa të madhësisë së binjakes së saj, të lënë në arë gjatë ikjes. Fjalë pas fjale arrin në një shtëpi ku edhe i jepnin shpresë se mund të mësojë diçka për fatin e foshnjës së lënë, të humbur... E zonja e asaj shtëpie i tregon se vajzën e kishte gjetur një grua dhe e kishte marr



me vete, që, sipas të gjitha gjasave, duhej të ishte afër fshatit.

Dhe, më në fund, arrin ta gjejë edhe fshatin, e edhe gruan që e kishte "gjetur" fëmijën e saj... Vajza tashmë gati ishte tri vjeçe... nuk i ndahej gruas që kujdesej për të dhe e dinte për nënë të veten.

"E paske rritur më mirë sesa unë binjaken tjetër!", i thotë ajo në shenjë falënderimi që e ka "gjetur" dhe e ka rritur si fëmijën e vet...

## KRIMI NË GRASHTICË E MAKOC

Nga data 18 deri më 21 prill në Grashticë e Makoc të Gallapit, paramilitarët serbë, më saktë forcat e drogua të Arkanit, kanë vrarë e masakruar 40 shqiptarë civilë, të cilët deri ato ditë kishin jetuar në fshatrat e viseve malore Marec e Mramor. Ofensiva artilerike serbe, që kishte granatuar fshatrat malore, kishte bërë që banorët e zhvendosur nga Prishtina të mësynin përsëri Prishtinën, pasi zgjidhje tjetër nuk kishin. Forcat e Arkanit famëkeq kishin zënë pusinë në tre vende përgjatë rrugës për në Prishtinë. Të zhvendosurit e parë që ktheheshin me traktorë në kryeqytet,

binin në pritën e parë të forcave serbe në Grashticë, konkretisht në lagjen Ugriaj të Grashticës, ku u kryen në sy të kolonës krimet më të tmerrshme të para ndonjëherë. I nxorën të rinjtë nga qerret dhe ua shkulën flokët për së gjalli. Të tjerëve ua thyen gishtërinjtë e duarve, gjithashtu, për së gjalli. Një të riu tjetër, pasi ia thyen gishtërinjtë, ia përdrodhën qafën. Që të gjithë më pas i vranë, duke i lënë pranë rrugës që t'i shihte kolona. Një nëne me mbiemrin Haxholli, iu ofruan për t'ia marrë djalin e vogël nga duart. E tërhoqi një paramilitar tullac dhe i drogouar, por nëna nuk e lëshoi. I revoltuar që nuk mundi t'ia merрте djalin nga dora, nënës i ra thikë në kofshët e këmbëve. Dhe, në atë gjendje e mbante djalin me fanatizëm, e gatshme të flijojë para tij nëse ia kërkonin të birin e vogël që i thoshte: "Nënë, mos më lësho!". Djali i saj ishte strukur në mesin e grave dhe nënave dhe me të hyrë në Prishtinë, aty ku ishte bombarduar kazerma ushtarake e fshatit Llukar, nëna e të birit kishte hetuar se këmbët i ishin lagur në çizmet e thella. Me t'i zbatuar pa se i ishin mbushur gjak, nga thika e paramilitarit të drogouar serb.

## MENDOJU KU ME TË PRE ME SHARRË DERISA TA PI CIGAREN!

Më 18 prill 1999, të njëjtën kolonë, pasi e kishin plaçkitur, një burrë, si shumë të tjerë, e kishin ndalur te sharra në Makoc. Ishte një punëtori sharre. Rreth saj ishte një mur llamarinash të zeza që e rrethonte sharrën. Një rom, e që quhej "Kasapi i Prishtinës", ishte ai që po i mbante pjesëtarët e kolonës shqiptare në rend për t'i futur në sharrë që t'ua hiqte ndonjë pjesë trupi. Kasapin e kishte marrë malli i duhanit dhe teksa e nxirrte nga kutia një cigare, i tha burrit që ndodhej i pari në radhë: "Mendohu ku të vjen më kollaj të të prej me sharrë! Ke kohë të mendosh derisa ta pi këtë cigare, se, pastaj, nuk kam kohë të të pres". Burri ishte tmerruar. Por, me të mbaruar romi cigaren, ishte ndalur rryma. Kasapi ishte bërë "burrë" dhe i kishte thënë: "Fati yt! Paskë shumë fat! Mbaje mend këtë ditë që është ditëlindja jote e parë se ti do ishe tash i vdekur!".

## THIKA NË KOKËN E DJALIT MEMEC

Ngjarja ka ndodhur në Krushë të Vogël. Fshat që humbi më 26 mars të vitit 1999 më se 220 burra, që lanë fëmijë e gra pa askënd për t'u kujdesur për ta. I kishin dëbuar banorët pas masakrës që e bënë te vendi "Vneshtat". Turma kishte mbetur më shumë në gra dhe fëmijë, e aty -këtu ndonjë djalë më i rritur. Në mesin e grave ishte edhe një djalë rreth 13 vjeç. Paramilitarët e përcillnin turmën, duke qëndruar përgjatë hekurudhës. I bërtet një paramilitar djalit, duke i thënë si quhej dhe sa vjeç ishte... Djali nuk mund të fliste se kishte defekte, e i traumatizuar, as që mund të thoshte ndonjë fjalë. Ai më shumë belbëzoi sesa që foli gjë...

E, paramilitari, duke mos qenë i kënaqur me përgjigjen e tij, e ndali fëmijën dhe ia vuri majën e thikës në flokë. Nëna përpëllitej me britma të mëdha... Turma vazhdon për në Shqipëri, por sot e atë ditë nuk dihet gjë për fatin e djalit...

## NË PLEQËRI - NËNË

Në lagjen Hoti një nënë kishte marrë në jetimore një djalë për ta bërë zot shtëpie, që të mos i fikej tymi i shtëpisë. Sepse, ia kishin vrarë burrin dhe djemtë. Shtëpia kishte mbetur në një grua dhe të një vajze të martuar...

Plakës ia kishin djegur shtëpinë dhe jetonte në shtëpi të improvizuar. Ishte bërë nënë në pleqëri, vetëm e vetëm që vajza e saj kur të vinte në gjini të kishte një "vëlla".

S. Krivaça





Ilustrim - hapja e shkollës shqipe në Londër

# Shqiptarët në Angli - komunitet me perspektivë

*Në dekadat e fundit, shqiptarët kanë gjetur një shtëpi të dytë - Anglinë, duke u bërë pjesë e një prej komuniteteve më të spikatura e punëtore.*

Migrimi shqiptar në Mbretërinë e Bashkuar ka rrënjë të thella, që nga vitet 90, kur shumë shqiptarë të Kosovës kërkonin siguri dhe mundësi më të mira për jetesë, deri në ditët e sotme, kur brezi i ri kontribuon në fusha të ndryshme si në biznes, art, shkencë dhe sport.

## SHQIPTARËT - KOMUNITET I INTEGRUAR NË ANGLI

Shumë shqiptarë në Angli kanë bërë biznese të suksesshme, si: restorante, dyqane, firma ndërtimi dhe shërbime të tjera, e që kontribuojnë në ekonominë

lokale.

Ata janë të njohur për punën e palodhur dhe aftësinë për t'u përshtatur me një realitet të ri, duke mbajtur, njëkohësisht, të gjalla traditat dhe kulturën shqiptare.

Festat kombëtare, veçmas, i tubojnë shqiptarët kudo që ndodhen në Angli. 28 Nëntori festohet çdo vjet në Londër. 28 Nëntori (shpallja e mëvetësisë së Shqipërisë), si dhe 17 Shkurti (shpallja e Kosovës shtet), janë shndërruar në ngjarje të rëndësishme. Në këto data, dhe jo vetëm në këto data, shqiptarët në Angli mbliidhen për të festuar dhe ndarë krenarinë kombëtare.

## RUAJTJA E IDENTITETIT KOMBËTAR

Kemi një potencial të jashtëzakonshëm për të kontribuar më tej në shoqërinë britanike, duke sjellë më vete një ndjenjë solidariteti dhe përkushtimi. Bashkëpunimi ndërmjet komunitetit shqiptar dhe institucioneve britanike mund të ndihmojë në ruajtjen e identitetit kombëtar, ndërkohë që forcohet edhe integrimi në shoqërinë vendase.

Sidoqoftë, jemi shembull i gjallë i forcës dhe rezistencës së një populli që gjithmonë gjen mënyra për të lulëzuar kudo që ndodhet.

**Naim Sadiki, Londër**

31 JANAR - 3 SHKURT

 **anaderm**

Spitali Special për Kirurgji  
Estetike dhe Plastike

Doc.Dr.

**IVO  
DŽEPINA**

Specialist i  
Kirurgjisë Estetike  
dhe Plastike

*Shën Valentini*

**SUPER ZBRITJE**

Na ndiqni për detajet dhe përgatituni për një befasi të paharrueshme!



# Burrin e kam me një dërrasë eksik!

*Sa i mbusha 18 vjet më martuan në një fshat të Ferizajt me burrin 40 vjeç. Në atë kohë isha e re, e bukur dhe rrallëherë më kishte rastisur të shkoja në fshat te një i afërm yni.*

*E, se bëhem grua fshati, kurrënjëherë nuk më kishte shkuar mendja...*

Ndodhi si ndodhi e u martova. U martova me burrë 40 vjeç, ani pse unë sapo i kisha mbushur të 18-at.

Por, e keqja ishte se burri im që në muajin e parë të martesës nisi të dyshonte se e tradhtoja me djalin e axhës së tij, i cili aso kohe ishte në vitin e parë të studimeve në Prishtinë, në qytetin ku kisha lindur e jetuar deri në ditën kur u bëra nuse.

"Ti po ma shikon gruan!", i gjuhej im burrë gjithsecilit që më shikonte.

Dhe, për të mos ardhur te më e keqja, te ndonjë konflikt, njerëzit nisën të rralloheshin, madje edhe të afërmit e burrit tim...

## EDHE VËLLANË E TIJ E AKUZONTE!

Në shtëpi, veç me burrë, jetoja edhe me vjehrrën, kunatin me grua dhe dy fëmijë të vegjël të tyre.

E, pse na u larguan fqinjët nuk e kisha dert. Tek e fundit, mua askush nuk më nevojitej

për muhabet, sepse e kisha burrin, vjehrrën e kunatën dhe me ta komunikojta. Por, e keqja e madhe ndodhi kur një ditë im burrë bëri fjalë edhe me vëllanë e tij, kinse edhe ai më shikonte me një sy ndryshe...

"Hej, njeri!", i thashë: "A po di se çka po thua?! A po di çka po bënë?! Si i thuhet vëllait ashtu?!".

Ai kërcëu si zorra n'prush. Nuk la gjë pa më thanë... Kinse unë isha ajo që i ndjellja "qentë" pas!

Në ato momente humba toruan.

Çdo gjë m'u mjegulla para syve. Shkova në dhomën time, u mbylla. Nisa t'i paketoj veshjet e mia në valixhe...

Burri erdhi te dera dhe mu lut ta hapja derën që të bisedonim.

E hapa derën. Hyri brenda.

Kur pa se rrobati i kisha bërë gati në valixhe, më tha:

"Hë, do shkosh në familje ndonjë ditë, a?"

"Po, sepse jam mërzitur shumë për nënën!", ia ktheva.

Dhe, fjalë pas fjale, prita derisa u qetësua dhe doli nga dhoma jonë e fjetjes.

Më vonë u kthye dhe më tha se më vonë do shkoj në qytet.

"A do vish me mua?", më tha.

"Jo, shko ti. Në familje do shkoj nesër", ia ktheva.

Dhe, kur mendoja se tashmë veç kishte aritur në qytet, e luta djalin e axhës së tij që me veturë të më ofroj te familja ime.

Në fillim, hezitoi.

E dinte se do t'i dilte telashe me tim burrë, e, pas pak, më tha: "A je gati?"

Kur arrita në shtëpi u tregova krejt çka kisha për t'u thënë...

Dhe, përkundër lutjeve të burrit tim se më nuk kemi me pasur problem kurrë, i rashë vijë njëherë e përgjithmonë dhe më nuk u ktheva në atë shtëpi.

Sidoqoftë, tash e 10 vjet jam e ve dhe me kë rri mundohet të më përvetësoj për nevoja të tyre, e jo edhe për martesë...

Keq, a?

**Valbona, Prishtinë**

# Syri i saj rrush Rahoveci!

*Kisha nxituar të arrija në kohën e duhur, prandaj i kisha dhënë turr automobilit gjatë gjithë rrugës. Posa arrita në vendin dhe kohën e caktuar, i telefonova mikës së saj, nëpërmjet së cilës mbaja lidhjen që nga dita e parë e njohjes sonë...*

"Di gjë për të dashurën time?" e pyeta, meqë e dashura ime nuk kishte dal në kohën e caktuar aty ku duhej të takoheshim.

Dhe, mikja më përcolli porosinë nga e dashura ime, me të cilën ajo më informonte se do të takohesh me mua në orët e pasdites.

Sidoqoftë, ishte paradite, andaj koha deri te takimi pasdite ishte bukur e gjatë e monotone...

Në orët e pasdites ajo po vinte anës bulevardit të zhurmshëm, e ngarkuar me një lloj faji që nuk ishte i saj.

E, me të arritur pranë tavolinës sime, u përshëndetëm ngrohtë, siç përshëndeten të dashuruarit...

E shikoja me lakmi, si një i dashuruar që isha, përgjatë gjithë trupit, që nga maja e gishtërinjve të këmbës e deri te majat e flokëve. Vëreja se ngjyrën e thonjve në gishtërinj të këmbëve e kishte harmonizuar me ngjyrën e thonjve të gishtërinjve të duarve.

Po ashtu, vëreja se edhe ngjyrën e çantës e kishte harmonizuar me këpucët dhe veshjen e saj, të cilën e kishte zgjedhur me

shije.

Nuk arrita të kuptoja për ngjyrën e zezë të flokëve se a e kishte përshtatur me vetullat harkore të zeza, apo me sytë e zezë që i kishte si kokrra rrushi të Rahoveci.

## SHKRIHESHA SI KANDILI NË BUKURINË E SAJ...

Dhe, derisa po e shikoja, shkrihesha i tëri në bukurinë e saj të rrallë. I mundur nga ndjenjat, më bëhej se kisha pranë veti një princeshë, që më çmendte me madhësinë e saj.

Sa e bukur dukej e sa me ëmbëlsi fliste! Më dukej se nxirrte mjaltë prej goje kah fliste, e kur më hidhte shikimin - sikur gjuante shigjeta nga sytë e saj.

Dhe, në një moment të caktuar, derisa po kënaqesha duke e vrojtuar, me droje më pyeti:

"Je mërzitur gjatë pritjes për takim?"

E shikova me shikimin e një të dashuruarit, ndonëse vetë shikimi fliste mjaft.

"Jo. Ndoshta do të mërzhitesha për çka do tjetër, por për pritjen e takimit me ty - as-

sesi".

E, fjalët e mia sikur i dhanë zemër. Deshi t'më hidhej në përqafim për t'më falur një puthje, por nuk pati guxim.

Në vend të puthjes më dhuroi një shikim të zjarrtë.

Pas kësaj lëshoi shikimin për tokë dhe pa më shikuar më tha:

"Më fal për vonesë!"

Unë, pa folur asnjë fjalë, afrova trupin afër trupit të saj.

Dhe, kur ndjeva nxehtësinë e saj, mu duk se po i shtohesh edhe më tepër bukuria, e cila sakaq më humbte para syve.

"Erdhe kur në imagjinatën time dukej sikur po shteronte parafytyrimi për të bukurën, kur më bëhej se po më mungonte fuqia për ta shijuar të bukurën. Prania jote po e rikthen ndjenjën, po e ringjallë fuqinë e po më frymëzon për ndjenjë të pasur, me të cilën do ta përshkruaja bukurinë tënde madhështore", i thashë.

E, për të plotësuar dashurinë tonë, u përqaftova fort, duke shkëmbyer puthje të zjarrtë, e cila ishte dhurata më e mirë e dashurisë sonë...

P. K.





Përjetimet tuaja mund të na dërgoni në email adresën e Revistës Kosovarja  
[info@kosovarja-ks.com](mailto:info@kosovarja-ks.com)

# Nuk po mund ta harroj atë që ma mori virgjërinë

*E pabesueshme, por e vërtetë. I mbusha rrafsh 40 vjet, jam e martuar, por ende nuk po mund ta harroj atë që ma mori virgjërinë...*



40 vjet sapo i kam mbushur. Por, në kohën kur isha 25 vjeçe, pas kryerjes së studimeve, u njoha me një njeri, i cili ma ndërroi kahen e jetës sime. Ai ishte disa vjet më i madh se unë. Duheshim shumë dhe çdo ditë takoheshim fshehurazi nga njerëzit, por më shumë ngaqë familja ime nuk donin që unë të shoqërohesha me të. Ai ishte marrëzishit i dashuruar dhe unë çmendesha pas tij...

Takoheshim çdo ditë. Rrinim bashkë, shëtisnim bashkë... Ai nuk ngutej në asnjë veprim: nuk i bëhej vonë për asgjë. Kjo më bënte të kuptoja se ai, vërtet, më donte... Më kishte premtuar se kurrë nuk do të bënte diç jashtë dëshirës sime...

Një ditë i tregova për historinë e dashurisë sime nuses së xhaxhait, sepse doja të merrja nga ajo mendimin e saj, meqë ajo kishte një vit martesë dhe e dija se veç kishte bërë një përvojë në dashuri. Por, ajo më foli dhe më preku me fjalë, duke më thënë se ai që ta merr virgjërinë kurrë nga mendja nuk të heqë... Dhe, kjo bëri që unë t'i jepesha atij edhe më shumë, madje vendosa edhe t'i jepja virgjërinë, e që për mua ishte e shenjtë, sepse në këtë frymë edhe isha edukuar në familje... Por, koha ecën dhe nuk patëm fatin të martoheshim... Sepse, para nesh ndodheshin hendeqe që nuk kapërceheshin dot... Andaj, edhe u ndamë...

Kaluan do vite dhe erdhi koha të martohem. Tash jam e lumtur, sepse kam krijuar një familje të shëndosh, por nuk më hiqet nga mendja kurrë ai, ai të cilit dikur iu dhashë me mish e shpirt. Atij të cilit edhe ia dhashë virgjërinë time të shenjtë, e për të cilin veprim nuk jam penduar asnjëherë në jetë.

Por, as tash, e që shkela në të 40-at, nuk po mund ta harroj...

L.



# SEASIDE SERENITY SPA EXPERIENCE

LIMITED TIME DEAL - BOOK NOW

PRICE 114/€ couple

For more info & Reservations

Rr. "Aleksandër Moisiu", Vlorë, Albania | +355 69 604 1000 | [info@marinabay.al](mailto:info@marinabay.al)





# Sa mirë ish me dekë!

*Një mërgimtar kishte ardhur nga Amerika në Kosovë, që të merrte pjesë në një varrim. Dhe, befasohet me atë që sheh e dëgjon...*

I vdekuri vajtohej nga gratë e familjes. Vajtoret ia radhitnin epitetet më të mëdha, duke ia numëruar të mirat, por edhe duke i thënë se vdekja e tij ka lënë zbrazësi të madhe në mesin e tyre...

Mërgimtari, meqë më parë nuk kishte marrë pjesë në ceremoni të tilla, iu duk mirë kjo gjë.

Kur u kthye në shtëpi, e pyeti gruaja: "Qysh kaloi ceremonia e varrimit?". "Nuk ishte keq të vdesësh, grua! Shumë urime e shumë lavde u thanë për atë burrë! Kishte qenë njeri i

madh...

Dhe, kur i dëgjova gjithë ato lavde, nuk ishte keq me vdekë", ia kthen ai. "A ke dëshirë ta provosh, pra?! Bëhu se ke vdekur e unë t'i numëroj lavdet një nga një...", ia kthen gruaja.

Burri shtrihet në krevat dhe bëhet si i vdekur.

Gruaja i afrohet afër dhe nis ta vajtoj...

"O burri im, po burri që ke qenë! Më të mirë se ty nuk ka pasur nahia jonë!

E ke lënë katundin keq!

Çka do të bëjnë tash pa ty?!", i thotë

ajo dhe buza i shkon në gaz.

Burri, kur sheh se gruaja nisi të qeshë, i thotë:

"Hë, pse qeshe?! U gëzove që kam vdekur, a?!"

"Qesha se asnjë prej atyre që t'i thashë ti s'i ke, andaj më shko buza në gaz! Prandaj, qohu, baju, shko në Amerikë, se atje nuk të njohin dhe mund të të lavdërojnë! Përndryshe, unë dhe familja jote të njohim mirë dhe e dimë se ç'bërllok je!", ia kthen ajo me të shpejtë.

**S. M.**

# Flaka u daltë çikave!

*“M’u ndal fryma kur e pash një femër sot se çka kishte veshur. Po, a mundet njeriu i gjallë të qëndrojë në vend kur i kalon para hundëve një seks-bombë si ajo?*

*Kam jetuar disa vjet në Gjermani, por, të them të drejtën, kurrë në jetën time nuk kam parë femër më të bukur sesa atë që pash sot. Dhe, asnjë mashkull normal nuk mund ta durojë këtë “nxehtësi të madhe” që po e krijojnë vajzat tona, e që po na e qesin flakën kur po i shohim.*

*A thua, a vuajnë edhe ato si ne, meshkujt, kur po na kap të nxehtit?”, tha Kreshniku, 29 – vjeçar, teksa bisedonim në një kafiç në Prishtinë, në “Qafë”, duke pirë kafe.*



E veshur me fustan deri te gjunjët, por me ngjyrë të kuqe, Jehona, 19 vjeçe, ecte kokëlartë përpara disa meshkujve që ia kishin ngulur sytë nga tavolina e lokalit kur rrija unë me Kreshnikun.

“Krejt tokën e babës e shita për të”, më thotë Kreshniku, teksa e shikonte Jehonën kah ecte kokëlartë, e i cili sikur dëshironte ta përbinte të tërën me shikim.

Jehona vazhdoi rrugën e vet dhe as që i bënin përshtypje shikimet e meshkujve të shumtë, të cilët e përcillnin me kureshtje ecjen e saj. Mënyra se si ajo ishte veshur dhe qëndrimi indiferent i saj, te meshkujt linte ndjenjën e të dëshpëruarve, të cilët do të shohin dhe do t’i terin sytë tërë ditën, duke parë edhe vajza të tjera eksituese si Jehona.

## “NE, DJEMTË, PO DIGJEMI NGA BRENDA”

“Nganjëherë po më duket vetja si robot kur po shoh femra shumë eksituese. Ato e zbulojnë trupin e tyre, kurse ne, meshkujt, digjemi nga brenda. Nuk di kush po i mëson kështu femrat tona? Kur u ktheva nga Gjermania mendova se do të martohej menjëherë, por, edhe pse ka femra sa të duash, unë nuk po mund ta gjej atë që do e merrja për grua, ani pse të mira e të bukura ka sa të duash në Prishtinë, Pejë e Prizren. Nganjëherë më shkon mendja të martohej si në kohën e prindërve të mi,

me mesit, ta marrë një grua nga fshati, e cila nuk di se çka është qitja e kërthizës jashtë, si këto të qytetit. Por, edhe ato në fshat kanë ndryshuar dhe nuk janë më si dikur. Edhe ato sillen e pështillen”, tha në fund të bisedës sonë teksa pinim kafe, Kreshniku.

## “ME RËNDËSI ËSHTË SE JAM NË FORMË”

“As që më intereson se çka mendojnë të tjerët për mua se si vishem e si dukem. Me rëndësi është se unë po ndjehem mirë, në formë. Dhe, kjo për mua ka rëndësi”, më tha të nesërmen Jehona, teksa e takova në rrugë, e që shkonte në punë në një butik, i cili ndodhej në Pallatin e Rinisë në Prishtinë.

Kreshniku, por edhe të tjerë si ai, megjithatë, janë të mendimit se është mirë që edhe vajzat tona e kanë thyer “mitin”, si dhe “mentalitetin e ndryshkur”, që ka dominuar gjithmonë në Kosovë. Sot gjithkush vishet si të dojë dhe kjo është shenjë e mirë se edhe rinia jonë po civilizohet dhe prindërit nuk i fusin më hundët në jetën e tyre në këtë aspekt. Sepse, edhe vajzat duhet ta jetojnë jetën e tyre ashtu si duan ato, e jo vetëm si duan të tjerët. Nuk duhet etiketuar vajzat si prostituta pse vishen hollë apo në mënyrë eksituese, sepse ajo është shije e tyre dhe asgjë më shumë.

B. B.





# 3 shenjat e Horoskopit që betohen për dashuri të përjetshme

*Tri shenjat e Horoskopit që betohen për dashuri të përjetshme janë: Demi, Gaforrja dhe Peshorja.*

## DEMI

Demi pëlqen sigurinë dhe harmoninë në marrëdhëniet e tyre, andaj edhe sivjet do të kenë zhvillime të mëdha në fushën e marrëdhënieve në çift. Pra, sivjet, nëse je Dem dhe je ende beqar, përgatit listën e të ftuarve dhe zgjidh kostumin, e nëse je femër zgjidh fustanin tuaj të nusërisë, sepse dasma po vjen!

## GAFORRJA

Gaforrja është burrë romantik dhe familjar nga natyra. Sivjet Gaforret që janë vetëm do të

ndiejnë se kanë gjetur personin e duhur për të ndërtuar të ardhmen e tyre.

Hëna, e cila sundon këtë shenjë, do t'i shtyjë ata të bëjnë hapin e madh. Një propozim martese apo edhe organizimi i ceremonisë sivjet është shumë i mundshëm.

Nëse jeni Gaforre, bëhuni gati për shumë lot gëzimi dhe emocione!

## PESHORJA

Peshorja njihet për nevojën e saj për ekuilibër dhe harmoni në marrëdhënie.

Sivjet dashuria për Peshoren do të jetë më e fortë se kurrë dhe do ta çojë atë në derën e ofiqarit.

Afërdita, planeti i dashurisë, do të luajë një rol vendimtar në marrjen e vendimeve serioze.

Andaj, Peshorja do të ndihet e gatshme të angazhohet dhe të ndajë jetën e tyre me personin që dashuron. Kështu, pavarësisht nëse po përgatiteni të jetoni përrallën tuaj, ose thjesht i doni parashikimet romantike, viti i sivjetmë për këto 3 shenja të Horoskopit premtan të jetë plot me momente të lumtura dhe premtime dashurie të përjetshme...



# Revolucion në DOBËSIM

E themeluar në vitin 2011 nga Shkenda Dubova, me një qendër fillestare në Prishtinë. Rugëtimi ynë nisi në një kohë kur aparaturat nuk njiheshin në vendin tonë. Qendra jonë solli një inovacion për tregun Kosovar dhe jo vetëm. Kjo na bëri të ndihmojmë shumë njerëz duke përbushur ëndrrat e tyre.



Perforco  
vaten



Detoksifikohu



Relaksohu



Balanco  
Shëndetin



PARA



PAS



PARA



PAS



PARA



PAS

Prishtinë

+383 45 224 540

Prizren

+383 43 900 902

Gjilan

+383 45 505 043

Gjakovë

+383 44 545 444



## MAGJISTARJA

[lindjavdekja@hotmail.com](mailto:lindjavdekja@hotmail.com)



Për hapje të fatit, për strese, sëmundje depresive, për forcim të bashkëshortësisë, për largim të magjive, për ecje të mbarë të biznesit, për rritje të vetëbesimit dhe për sugjerime e ndihmë me barëra popullore, por edhe për gjithçka për jetë të lumtur

*kontaktoni në këtë email adresë:*

[lindjavdekja@hotmail.com](mailto:lindjavdekja@hotmail.com)

### **A do të bëhem gruaja e tij?**

Përshëndetje, jetoj në Belgjikë. Jam me një person që sa vjet në lidhje. Më ka premtuar dhe më premton se do të martohemi.

E di tërë familja e tij që ai më ka mua paralelisht me bashkëshorten e tij franceze, madje edhe gruaja e tij!

E, shkaku se jam me probleme, po kam nervozë që dy vjet, në pritje që ai të vendosë për fatin tonë.

Sidoqoftë, vitet po kalojnë dhe unë kam mbetur në pritje...

Të lutem, çka të bëj, sepse më nuk po di me e gjet "rrugën se më ka humbur në oborr!"

**"Në pritje"**

### **Përgjigje:**

*Para së gjithash, nuk ka grua që ia jep dikujt tjetër bashkëshortin e vet!*

*Dhe, sado që ti thua se e di familja e tij, sado që ndihesh mirë për këtë gjë, ti po ndërhysh në burrin e huaj.*

*Nuk po paragjykojmë në mënyrën tonë fetare, do të thotë në mënyrën islame, sepse me Kuran kjo të jep të drejtë ty*

*dhe atij, por të drejtën e shkelë praktika, jeta.*

*Por, realiteti është ndryshe - ai nuk po të merr për grua, e kjo rrënon çdo gjë.*

*Andaj, nëse nuk të merr për grua, çka pret prej tij?!*

*Pra, më mirë të tërhiqesh tash se më vonë...*

### **A është mirë që bashkëjetoj me të dashurin?**

Jam 22-vjeçare, studente në Prishtinë. Jam nga Skivjani i Gjakovës.

Bashkëjetoj me të dashurin, po ashtu, student.

Kemi shpesh mosmarrëveshje, por e di se më do shumë...

Por, kam një brengë: Frikësohem se pas studimeve secili do të shkojmë rrugës së vet!

**"Studentja nga Skivjani"**

### **Përgjigje:**

*Ju nuk e keni bërë zyrtare lidhjen tuaj, nuk jeni fejuar! E, fejesa është akti i zyrtarizimit të një lidhjeje. Pra, është para martesë.*

*E, te ju nuk ka ndodhur fejesa, por bashkëjetesa! Andaj, askush mund të mos di për lidhjen tuaj.*

*Jeni takuar në Prishtinë, jeni njohur në Prishtinë, flini bashkë në banesë dhe një ditë edhe mund të shkoni secili rrugës së vet, ashtu si edhe është brenga jote...*

*Pra, asnjëri nuk keni të drejtë morale e as ligjore të kërkojë llogari prej palës tjetër!*

*Këtë që jeni duke bërë është vetëm një kalim kohe, e që e sjellë koha si dukuri dhe asgjë tjetër, sepse të dashurin tënd nuk e ke as të fejuar e as burrë, por jeni dy të rinj që po i shfrytëzoni ndjenjat e njëri-tjetrit për aq kohë sa jeni në Prishtinë.*

### **Pse vajza ime rri veç t'u qeshë?**

Ajo që më shtyri t'u shkruaj është brenga ime se shumë herë vajza ime, tash në pubertet, qeshë shumë!

A ka diçka të keqe apo iu ka bërë shprehi?

**"Nëna e brengosur"**

### **Përgjigje:**

*Të qeshurit është një proces që vjen nga truri.*

*Por, as shkenca ende nuk e ka përgjigjen rreth asaj se si shkaktohet dhe cilat fije nervore e koordinojnë trurin me buzët apo me anën tonike të të qeshurit me zë.*

*Vetëm njeriu prej të gjitha krijesave e posedon të qeshurit, si një dukuri që është fenomen në vete. Shkenca psikiatrike-neurologjike nuk ka dhënë shpjegime si shkaktohet kjo dukuri te njeriu dhe nëse ka gjëndra të caktuara që ekzistojnë për të shkaktuar të qeshurit.*

*Nëse njeriu mendon se qeshja shkaktohet nga një batutë, apo nga një fjali argëtuese, që është shaka apo humor e satirë, si shpjegohet të qeshurit kur nuk flitet për asgjë? Por, edhe atëherë kur nuk flasim - qeshim! Kjo të jep të kuptosh se mendja rri te një rrëfim, te një batutë, te një ndodhi...*

## **Një dreq i madh është ndërmjet nesh!**

Jam nënë e dy fëmijëve. Jetoj në Mitrovicë. Kam probleme me burrë, por nuk di si kanë lindur ato, sepse s'kemi pasur asgjë konkrete mes nesh si probleme të pakalueshme. Mendoj se duhemi ende. Por, ajo që po më brengos shumë janë fëmijët. Ata, disi, nuk heqin dorë nga babai i tyre. Një dreq i madh është ndërmjet nesh!

### **“Nëna e 2 fëmijëve”**

#### **Përgjigje:**

*Ndërmjet jush kanë hyrë inatet dhe janë bërë një lloj kanceri bashkëshortor. Nuk keni asgjë të madhe që të ndaheni, por keni gjëra të vogla, të cilat nuk keni fuqi t'i kaloni. Të dy e keni ndjenjën e fajësisë për njëri-tjetrin dhe të dytë keni gabime. Keni mostolerancë ndaj njëri-tjetrit. Andaj, nuk do të shkojë shumë kohë dhe do i kaloni të gjitha...*

## **Nuk po mund ta gjej rrugën e jetës?**

Jam burrë 50 vjeç, jetoj në Prishtinë. Kam qenë një kohë në Turqi, ku edhe kam qëndrim të përhershëm, por ka dy vjet që jam kthyer në Kosovë. Më ka humbur rruga në oborr, siç thotë populli dhe s'di çka po ndodh me mua... Kam bërë shumë të mira dhe nuk e kam merituar të vij në këtë pozitë, që të mos kem mundësi shpirtërore të jem vetvetja që isha dikur. Më janë mbyllur të gjitha rrugët e jetës: Nuk më punohet, nuk jam i kënaqur as i lumtur me asgjë që kam krijuar deri tash. Ç'shëh syri yt për mua, zonja magjistare?

### **“Limoni”**

#### **Përgjigje:**

*Çdo kërkesë e njerëzimit lidhet për më shumë fat. Fati është në çdo periudhë të jetës. Dhe, kur jemi ngushtë, i drejtohem Zotit dhe fatit! Por, ju keni magji. Dëshmitë do t'i gjeni në shtëpinë ku jetoni sot. Në njërin dhomë i keni tri këmisha të prera dhe të gjakosura. Nxirrni nga ormani dhe hidhni jashtë shtëpisë! Dhe, pas një kohe te ju do të ndryshojnë gjërat për të mirë.*

## **A ka jetë në univers?**

Jam një zonjë nga Suedia, me profesion mjekje. Teknologjia ka arritur majat e zhvillimit. Më intereson të di:

## **PËR LEXUESIT E DIASPORËS**

Pyetjet tuaja dërgoni me postë në adresën: “Kosovarja”, fahu postal 18, 10 000, Prishtinë, Kosovë.

A ka jetë në univers, përveçse në planetin Tokë.

### **“Mjekja e përgjithshme”**

#### **Përgjigje:**

*Përveç teknologjisë që po zhvillohet përditë e më shumë, Agjencia për Hulumtime Hapësinore “NASA” po zbulon planetë që nuk i ka njohur deri më tani shkenca. Gjatë udhëtimeve hapësinore, anijet kozmike me ekipet e ekspertëve, kanë kapur zëra që vijnë nga planetë të tjerë, si dhe zhurma të ndryshme që i përngjajnë dinamikës jetësore që zhvillohet në ndonjë qytet metropolik.*

*Andaj, nisur nga ky fakt i dëshmuar, mbetet për të besuar se në univers ka jetë dhe ne nuk jemi të vetmit banorë. Pra, kjo është sa i përket anës faktike që është dëshmuar, e sa i përket parashikimit tim del se ne nuk jemi të vetmit banorë në univers, por ka edhe të tjerë në ndonjë planet tjetër. Të dhënat për alienët (jashtëtokësorët), janë teza të pamohueshme.*

*E, ajo që nuk dihet është se a janë para nesh me shkencë e teknologji apo jo?*

*Megjithatë, mjetet vizëlluese, të quajtura UFO, janë shenja të qarta se janë shumë para nesh me zhvillim teknologjik...*





# DENTFIX

ORDINANCA STOMATOLOGIJE